



Velimir Dellovski  
Danica Xhonova

**Masat individuale për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si individualizim i ekzekutimit me theks të veçantë në përsëritjen e procedurave**

**Masat individuale për ekzekutimin**  
e aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane  
për të Drejtat e Njeriut si individualizim i  
ekzekutimit me theks të veçantë në  
përsëritjen e procedurave

**Botues:**  
Misioni i OSBE-së në Shkup

**Autor:**  
Velimir Delovski  
Danica Xhonova

**Redaktorë:**  
Darko Pavlovski  
Artan Murati

**Përktheu:**  
Valon Abdiu

**Lekturoi:**  
Lulzim Ademi

**Shtypi:**  
Polyesterday, Shkup

Masat individuale për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si individualizim i ekzekutimit me theks të veçantë në përsëritjen e procedurave  
**ISBN: 978-92-9271-058-3**

**Publisher:**  
OSCE Mission to Skopje

**Author:**  
Velimir Delovski  
Danica Djonova

**Editors:**  
Darko Pavlovski  
Artan Murati

**Translated by:**  
Valon Abdiu

**Proofread by:**  
Lulzim Ademi

**Graphic design:**  
Polyesterday, Skopje



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

#### Mbi përdorimin e emrit të vjetër të shtetit në këtë publikim:

Shteti zyrtarisht ndryshoi emrin kushtetues në vitin 2019 në përpuethshmëri me Marrëveshjen e Prespës. Shumica e akteve ligjore të krijuara para ndryshimit të emrit akoma janë në fuqi dhe përmbajnë emrin e mëparshëm të shtetit në titujt e tyre zyrtare. Përdorimi i emrit të mëparshëm të shtetit në këtë dokument bëhet vetëm për shkak të saktësisë ligjore.

## Përmbajtja

Parathënie	4
LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA	6
I. HYRJE	7
II. PËRSËRITJA E PROCEDURAVE DHE MASAT E TJERA INDIVIDUALE PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT SI FORMË E RESTITUTIO IN INTEGRUM	11
II.1. Masat individuale për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së	11
II.2. Përsëritja e procedurave si një formë e restitutio in integrum	13
II.3. Rekomandimi nr. R (2000) 2 i Këshillit të Evropës për rishqyrtimin ose rihapjen e procedurës gjyqësore për raste të caktuara në nivel nacional pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	15
II.4. Klauzola e rigjykimit	17
III. ASPEKTET SPECIFIKE TË PËRSËRITJES SË PROCESIVE GJYQËSORE VENDORE PËRMES PRIZMIT TË JURISPRUDENCËS SË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	21
III.1. Procedura pas kërkesës për përsëritjen e proceseve gjyqësore vendore pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si bazë për një procedurë të re para GJEDNJ-së	21
III.1.1. Çështjet që lidhen me pranimin e kërkesave të reja para GJEDNJ-së	21
III.1.2. Praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së	24
III.2. Përsëritja e procedurës në bazë të vendimit të GJEDNJ-së	30
IV. PËRSËRITJA E PROCEDURËS SI MASË INDIVIDUALE PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE DHE VENDIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LËNDËT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	34
IV.1. Korniza ligjore	34
IV.2. Praktika relevante gjyqësore vendore	39
V. SFIDAT NË PËRSËRITJEN E PROCESIVE GJYQËSORE VENDORE NË LËNDËT CIVILE DHE PENALE	48
V.1. Përsëritja e procedurave civile	48
V.2. Përsëritja e procedurave penale	50
VI. VËSHTRIM PËRMBYLLËS	52
ANEKSI:	53

## Parathënie

Misioni i OSBE-së në Shkup (në tekstin e mëtejshëm: “Misioni”), në kuadër të mandatit të tij programor për të mbështetur shtetin nikoqir në realizimin e angazhimeve të OSBE-së për sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, padyshim i është përkushtuar përhapjes së vlerave, standardeve dhe praktikave më të mira që kanë të bëjnë me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, “KEDNJ”, “Konventa”) dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “GJEDNJ”, “Gjykata”).

Nevoja për një qasje sistematike në forcimin e kapaciteteve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Konventës është pranuar nga palë të ndryshme të interesit dhe në nivele të ndryshme. Në bashkëpunim, para së gjithash, me Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, bashkërisht u konstatua nevoja që theksi në këtë fazë të vihet në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve, përkatësisht të vendimeve të Gjykatës në Strasburg. Mu për këtë arsye, në vitin 2021 dhe në fillim të vitit 2022, Misioni e mbështeti përpilimin e një trilogjie në temën e ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për dallim nga publikimi i parë, i cili ka të bëjë me mekanizmin e ekzekutimit të aktgjykimeve në nivel të Këshillit të Evropës dhe me specifikat e kornizës ligjore dhe institucionale nacionale për ekzekutimin e aktgjykimeve dhe publikimi i dytë, i cili për nga temat i kushtohet masave të përgjithshme, në këtë pjesë të tretë shtjellohen të ashtuquajturat masa individuale, gjegjësisht masat individuale për ekzekutim. Një fokus i veçantë në këtë publikim i kushtohet përsëritjes së procedurave gjyqësore vendore pas aktgjykimit të GJEDNJ-së, me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së (ose pas një vendimi të GJEDNJ-së) si një nga mjetet për të arritur të ashtuquajturën *restitutio in integrum*.

Nga pikëpamja metodologjike, ky publikim i tretë trajton përsëritjen e procedurave gjyqësore duke iu shmangur analizës së veçantë të çështjes së përsëritjes së procedurave administrative. Në të njëjtën kohë, ky publikim nuk merret me përsëritjen apo vazhdimin e hetimeve të kontestuara apo me fillimin e hetimeve të reja pas një aktgjykimi të GJEDNJ-së në të cilin është konstatuar shkelje e aspekteve procedurale të të drejtave nga Konventa, si një çështje më vete, e cila, për shkak të hapësirës së kufizuar, mbetet për t'u trajtuar në ndonjë material të ardhshëm.

Misioni shpreson se kjo pjesë e tretë do të jetë veçanërisht e dobishme për juristët praktikant (gjyqtarë, prokurorë, avokatë) të cilët çdo ditë përballen me dilema lidhur me zbatimin e Konventës, veçanërisht kur bëhet fjalë për zbatimin praktik të aktgjykimeve tashmë të miratuara, të cilat shteti ka detyrim ligjor t'i zbatojë plotësisht dhe në mënyrë efektive. Ekzekutimi korrekt i masave individuale, përkatësisht individualizimi adekuat i ekzekutimit, do ta përmirësojë edhe dosjen e Maqedonisë së Veriut para Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, si organ përgjegjës për ekzekutimin e aktgjykimeve.

Misioni pret që e tërë trilogjia të jetë e dobishme edhe për mendimin akademik, por edhe për vendimmarrësit, të cilët duhet të sensibilizohen dhe të informohen për këtë çështje, në mënyrë që ta vendosin, përkatësisht ta përmirësojnë vazhdimisht sistemin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standardet evropiane drejt të cilave synon Maqedonia e Veriut.

Për botuesin:

Misioni i OSBE-së në Shkup

Darko Pavlovski, Oficer i Lartë Juridik

Artan Murati, Oficer Nacional për Sundimin e Ligjit

## LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut/Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KM</b>	Komiteti i Ministrave
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>ARSIWA</b>	Articles on the Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts/ Nenet mbi përgjegjësinë e shteteve për aktet e paligjshme ndërkombëtare
<b>UN ILC</b>	United Nations International Law Commission/Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare i OKB-së

## I. Hyrje<sup>1</sup>

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të sistemit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është se ajo përfshin një mekanizëm për kontrollin e përputhjes me dispozitat e saj. Kështu, KEDNJ-ja jo vetëm që kërkon nga shtetet kontraktuese që në një kuptim abstrakt t'i respektojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj (neni 1 i KEDNJ-së), por në nenin 19, ajo krijon edhe një organ gjyqësor - Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është kompetente për konstatimin e shkeljeve të KEDNJ-së me aktgjykime që shtetet kontraktuese janë të detyruara t'i respektojnë (neni 46 paragrafi 1 i KEDNJ-së).

Gjithashtu, KEDNJ-ja në nenin 46 paragrafi 2, parashikon një mekanizëm për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve, i cili i është besuar Komitetit të Ministrave (në tekstin e mëtejshëm: "Komiteti", "KM"). Një mekanizëm i tillë e tregon rëndësinë në sistemin e GJEDNJ-së për zbatimin efektiv të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland (no. 2)* [GC], no. 32772/02, § 84, ECHR 2009).

### Neni 46, KEDNJ Detyrimi dhe ekzekutimi i aktgjykimeve

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër t'i respektojnë aktgjykimet përfundimtare të Gjykatës në kontestet në të cilat ato janë palë.
2. Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës i dorëzohet Komitetit të Ministrave, i cili e mbikëqyr ekzekutimin e tij.
3. Në rast se Komiteti i Ministrave vlerëson se mbikëqyrja e ekzekutimit të aktgjykimit përfundimtar pengohet për shkak të ndonjë problemi në interpretimin e aktgjykimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës, e cila do të marrë vendim për çështjen e interpretimit. Marrja e vendimit për referimin e çështjes në Gjykatë kërkon shumicë prej dy të tretash të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë si anëtarë të Komitetit.
4. Nëse Komiteti i Ministrave vlerëson se Pala e Lartë Kontraktuese refuzon ta zbatojë aktgjykimin përfundimtar, në një rast në të cilin ajo është palë, mundet, pasi t'i dërgojë një njoftim zyrtar asaj Pale të Lartë Kontraktuese dhe me një vendim të marrë me shumicë prej dy të tretash të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet, Gjykatës t'ia shtrojë pyetjen nëse ajo palë nuk e ka përmbushur detyrimin e saj nga paragrafi 1.
5. Nëse Gjykata konstaton shkelje të paragrafit 1, do t'ia referojë rastin Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhet të ndërmerren. Nëse Gjykata konstaton se nuk ka shkelje të paragrafit 1, do t'ia referojë rastin Komitetit të Ministrave, i cili do ta përfundojë shqyrtimin e rastit.

<sup>1</sup> Pjesa hyrëse e këtij publikimi përmban disa vërejtje të përgjithshme për sistemin e ekzekutimit të aktgjykimeve të vendosur në nivel të Këshillit të Evropës. Për më shumë detaje, shihni pjesën e parë të trilogjisë, me titull "Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar".

Paragrafi i parë i nenit 46 të KEDNJ-së e përcakton detyrimin e shteteve kontraktuese për t'i zbatuar aktgjyqimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paragrafët e tjerë të nenit 46 të KEDNJ-së e përcaktojnë kornizën për modalitetet procedurale në të cilat vlerësohen masat e ndërmarra nga shteti kontraktues për qëllimet e përbushjes së një detyrimi të tillë.

Procesi i ekzekutimit i referohet veprimit të shtetit kontraktues të KEDNJ-së në përputhje me detyrimet e tij sipas ligjit ndërkombëtar që dalin nga neni 46 paragrafi 1 i KEDNJ-së. Këto detyrime bazohen në parimet e së drejtës ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ndërprerjen e shkeljes, mos përsëritjen dhe dëmshpërblimin, siç del nga Nenet mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Veprimet e Paligjshme Ndërkombëtare.<sup>2</sup>

Çështja e ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së nga shtetet kontraktuese është jashtë juridiksionit të GJEDNJ-së, me përjashtim të rastit kur është iniciuar "procedurë për shkelje" të nenit 46, të parashikuar në nenin 46, paragrafët 4 dhe 5 të KEDNJ-së (*Moreira Ferreira v. Portugal* (no. 2) [GC], no. 19867/12, § 102, 11 July 2017)<sup>3</sup>. Vetëm në "procedurën e shkeljes" nga GJEDNJ-ja kërkohet të bëjë një vlerësim përfundimtar ligjor nëse shteti e ka respektuar aktgjykimin e GJEDNJ-së dhe detyrimin e tij sipas nenit 46 paragrafi 1 i KEDNJ-së. Me këtë rast, GJEDNJ-ja i merr parasysh të gjitha aspektet e procedurës përpara Komitetit të Ministrave, duke i përfshirë edhe masat që i ka theksuar KM-ja. GJEDNJ-ja e bën vlerësimin e saj duke i marrë parasysh konkluzionet e KM-së në procesin e mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjyqimit të GJEDNJ-së, qëndrimin e shtetit, përgjegjësia e të cilit kërkohet dhe pretendimet e viktimës për shkelje të të drejtave të njeriut. Në kuadër të kësaj procedure, GJEDNJ-ja i identifikon detyrimet ligjore që rrjedhin nga aktgjykimi i plotfuqishëm, konkluzionet dhe fryma e aktgjyqimit për të përcaktuar nëse shteti kundër të cilit është parashtruar aplikimi dhe përgjegjësia e të cilit kërkohet, nuk i ka përbushur detyrimet e veta nga neni 46 paragrafi 1 (*Ilgar Mammadov v. Azerbaijan* [GC], § 168, 29 May 2019).

Në të gjitha rastet e tjera, mbikëqyrja e ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së i besohet KM-së në përputhje me nenin 46 paragrafi 2 të KEDNJ-së. Në fakt, konsiderohet se Komiteti i Ministrave është në pozitë më të mirë se GJEDNJ-ja për t'i vlerësuar masat konkrete që duhet të ndërmerren për qëllime të ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së.

Komiteti i Ministrave, në bazë të informacionit të dhënë nga shteti i paditur dhe me vëmendjen e duhur ndaj zhvillimit të rrethanave që kanë të bëjnë me aplikantin pas aktgjyqimit të

<sup>2</sup> Articles on the Responsibility of States for Internationally Wrongful Acts (ARSIWA), janë në dispozicion përmes këtij linku [https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/commentaries/9\\_6\\_2001.pdf](https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/commentaries/9_6_2001.pdf). Ato, në parim, konsiderohen si pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare të kodifikuara. Në vitin 2001, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) vetëm e konstatoi miratimin e tyre nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare i OKB-së (United Nations International Law Commission (ILC)) dhe i publikoi ato si aneks të Rezolutës 56/83.2. Megjithatë, ato gëzojnë autoritet të lartë si shprehje e së drejtës zakonore ndërkombëtare në këtë fushë. Në fakt, edhe numri i vendimeve të gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare që i referohen ARSIWA-s e dëshmojnë rëndësinë e tyre.

<sup>3</sup> Kjo procedurë, për herë të parë, u aktivizua kundër Azerbajxhanit për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të organeve kompetente për të siguruar lirinë e pakushtëzuar të aplikantit (aktivistit politik) me qëllim të ekzekutimit të aktgjyqimit në lëndën *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan*, no. 15172/13, 22 May 2014. Në atë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor i GJEDNJ-së arriti në përfundimin se Azerbajxhani nuk i kishte përbushur detyrimet e tij sipas nenit 46 paragrafi 1 që të respektojë aktgjykimin e Gjykatës së vitit 2014.

GJEDNJ-së, e mbikëqyr marrjen e masave nga ana e shtetit. Mekanizmi i mbikëqyrjes sipas nenit 46 të KEDNJ-së ofron një kornizë gjithëpërfshirëse për ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së, të përforcuar me praktikën e Komitetit të Ministrave. Në praktikë, puna e vazhdueshme mbikëqyrëse e Komisionit ka krijuar një korpus të dokumenteve publike<sup>4</sup>, të cilat përfshijnë informacione të dhëna nga shtetet kundër të cilave janë miratuar aktgjyqimet e GJEDNJ-së nën mbikëqyrjen e ekzekutimit të Komitetit, informacione të dhëna nga palë të tjera të interesuara ose të përfshira në procesin e ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së<sup>5</sup>, si dhe vendimet e marra nga Komiteti i Ministrave për lëndët nën mbikëqyrjen e ekzekutimit.

Neni 41 i Konventës përmban një mekanizëm për përcaktimin e zhdëmtimit të drejtë për aplikantët që janë viktimë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të KEDNJ-së.

#### Neni 41, KEDNJ Zhdëmtim i drejtë

*Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe nëse ligji vendor i Palës së Lartë Kontraktuese të përfshira e lejon vetëm heqjen e pjeseshme të pasojave të asaj shkeljeje, ajo, nëse është e nevojshme, do t'i japë zhdëmtim të drejtë palës së dëmtuar.*

Megjithatë, zhdëmtim i drejtë i dhënë nga GJEDNJ-ja nuk i largon gjithmonë të gjitha shkeljet nga shkeljet e konstatuara të KEDNJ-së. Për këtë arsye mund të jetë e nevojshme që të përcaktohen dhe të zbatohen masa shtesë individuale për ekzekutimin e aktgjyqimit. Prandaj, aktgjykimi në të cilin Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj i imponon shtetit përgjegjës një detyrim ligjor jo vetëm për t'i paguar parashtruesit shumën e zhdëmtimit të drejtë të dhënë nga GJEDNJ-ja në përputhje me nenin 41 të KEDNJ-së, por edhe të zgjedhë një lëndë të mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave, të përgjithshme dhe/ose nëse është e përshtatshme, në rendin e tij ligjor të merren masa individuale për t'i dhënë fund shkeljes së përcaktuar nga Gjykata dhe për të zhdëmtuar në masën më të madhe të mundshme pasojat e saj (shih *Pisano v. Italy* (striking out) [GC], no. 36732/97, § 43, 24 October 2002 dhe *Scozzari and Giunta v. Italy* [GC], nos. 39221/98 and 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII)<sup>6</sup>, si dhe *Stanev v. Bulgaria* [GC], no. 36760/06, § 254, ECHR 2012 dhe *Sejdovic v. Italy* [GC], no. 56581/00, § 119, ECHR 2006-II).

Shteti kontraktues, në parim, është i lirë t'i zgjedhë masat me të cilat do ta zbatojë aktgjykimin me të cilin GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së, që është në përputhje me parimin e subsidiaritetit mbi të cilin bazohet sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

<sup>4</sup> Të disponueshme përmes bazës së të dhënave (<https://hudoc.echr.coe.int/eng>).

<sup>5</sup> Në pajtueshmëri me rregullin nu.9 të Regullave të Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e zbatimit të aktgjyqimeve dhe ujdive miqësore. Përkthimi i tyre në gjuhën maqedonase është i disponueshëm në ueb faqen e Biorës për përfaqësim, ketu: <https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/10/Правила-на-Комитет-на-Министри.pdf>.

<sup>6</sup> *Egmez v. Cyprus* (dec.), no. 12214/07, § 48, 18 September 2012

të bazuar në GJEDNJ. Kjo liri veprimi për mënyrën e ekzekutimit të aktgjykimit e pasqyron lirinë e zgjedhjes që ka të bëjë me detyrimin parësor të shteteve kontraktuese të KEDNJ-së – për t'i garantuar të drejtat dhe liritë e garantuara nga GJEDNJ-ja (*Papamichalopoulos and Others v. Greece* (Article 50), 31 October 1995, § 34, Series A no. 330-B).

Sidoqoftë, masat e marra nga shteti për ekzekutimin e një aktgjykimi të GJEDNJ-së duhet të jenë në përputhje me konkluzionet dhe frymën e aktgjykimit (*Ilgar Mammadov v. Azerbaijan* [GC], § 186, 29 May 2019). Diapazoni i detyrimeve ligjore që rrjedhin nga një aktgjykim i plotfuqishëm i GJEDNJ-së në përputhje me nenin 46 të KEDNJ-së përcaktohet nga arsyet për të cilat GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së (po aty., § 187).

Përderisa aktgjykimet e GJEDNJ-së janë në thelb **deklarative** nga natyra, në rrethana të caktuara, me qëllim që të ndihmojë shtetin t'i përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 46, GJEDNJ-ja mund të specifikojë llojin e masave individuale dhe/ose masave të përgjithshme që mund të ndërmerren për t'i dhënë fund situatës për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të GJEDNJ-së (*Suso Musa v. Malta*, no. 42337/12, § 120, 23 July 2013).

Për sa i përket masave individuale, në disa situata konkrete, GJEDNJ-ja mund ta konsiderojë të dobishme apo edhe të nevojshme t'i tregojë qeverisë përgjegjëse llojin e masave që mund ose duhet t'i marrë, e ndonjëherë natyra e shkeljes së konstatuar mund të jetë e tillë që nuk lë zgjidhje tjetër për sa i përket masës individuale që duhet të merret për qëllime të ekzekutimit të aktgjykimit të GJEDNJ-së (*Hirsi Jamaa and Others v. Italy* [GC], no. 27765/09, §§ 209-211, ECHR 2012; *Assanidze v. Georgia* [GC], no. 71503/01, § 202, ECHR 2004-II; *Al-Saadoon and Mufdhi v. the United Kingdom*, no. 61498/08, § 171, ECHR 2010; *Savridin Dzhurayev v. Russia*, no. 71386/10, §§ 252-254, ECHR 2013 (extracts)).

Prania ose mungesa e udhëzimeve të qarta lidhur me ekzekutimin e tyre, në vetë aktgjykimet e GJEDNJ-së, nuk është vendimtare për sa i përket asaj se një shtet a i ka përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 46 paragrafi 1 i KEDNJ-së. Ajo që është vendimtare është masat e ndërmarrë nga shteti a janë në përputhje me konkluzionet dhe frymën e aktgjykimit të Gjykatës (*Ilgar Mammadov v. Azerbaijan* [GC], 2019, § 186). GJEDNJ-ja në mënyrë plotësuese sqaroi se kufizimi i procesit të mbikëqyrjes kryesisht në vërejtjet e qarta nga ana e GJEDNJ-së do ta eliminonte fleksibilitetin e mbikëqyrjes së kryer nga KM-ja (në bazë të informatave të cilat i siguron dhe i publikon shteti dhe me kujdesin e duhur, duke marrë parasysh zhvillimin e situatës që ka të bëjë me vetë aplikantin), për sa i përket miratimit dhe ndërmarrjes së masave që janë të realizueshme, në kohë, të përshtatshme dhe të mjaftueshme (po aty, § 184). Kështu, Komiteti i Ministrave mund t'i rivlerësojë vërejtjet e përfshira në aktgjykimet e GJEDNJ-së, të cilat janë të rëndësishme për ekzekutimin, si për shembull, kur faktorë objektivë që janë bërë të njohur pas miratimit të aktgjykimit nga ana e GJEDNJ-së duhet të merren parasysh në procesin e mbikëqyrjes (po aty, § 183).

Deri më tani, GJEDNJ-ja asnjëherë nuk i është referuar nenit 46 të KEDNJ-së duke i theksuar masat, qoftë në pjesën e masave individuale apo në pjesën e masave të përgjithshme, të cilat pret që Maqedonia e Veriut t'i ndërmarrë për qëllimet e ekzekutimit të një aktgjykimi konkret të GJEDNJ-së me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së.

## II. Përsëritja e procedurave dhe masat e tjera individuale për ekzekutimin e aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si formë e *restitutio in integrum*

### II.1. Masat individuale për ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së

Shteti duhet të heqë çdo pengesë në sistemin e tij ligjor që mund ta pengojë korrigjimin adekuat të situatës së aplikantit (*Maestri v. Italy* [GC], no. 39748/98, § 47, ECHR 2004-I). Për dallim nga masat e përgjithshme që duhet të parandalojnë shkelje të ngjashme të KEDNJ-së duke i zgjidhur problemet sistematike nga të cilat lind shkelja e konstatuar e KEDNJ-së, masat individuale për ekzekutimin e aktgjyqimeve të KEDNJ-së kanë për qëllim përmirësimin e situatës së vetë aplikantëve, gjegjësisht kthimin e tyre në masën më të madhe të mundshme, në gjendjen në të cilën do të kishin qenë nëse do të ishte respektuar KEDNJ-ja dhe nëse nuk do të kishte ndodhur fare shkelja e KEDNJ-së. Në fakt, shteti përgjegjës për aktin e kundërligjshëm është i detyruar të sigurojë “kthimin në gjendjen e mëparshme” (*restitutio in integrum*), gjegjësisht ta rikthejë gjendjen që ka ekzistuar përpara se të ndodhte akti i kundërligjshëm, me kusht që kjo të jetë e mundur dhe përfitimi nga kthimi të mos supozojë barrë jo proporcionale në krahasim me dobinë nga pagesa e dëmshpërblimit.<sup>7</sup> Me fjalë të tjera, edhe pse kthimi në gjendjen e mëparshme është rregull, mund të ketë rrethana në të cilat shteti përgjegjës përjashtohet – tërësisht ose pjesërisht – nga ky detyrim, me kusht që të mund ta dëshmojë ekzistencën e rrethanave të tilla. *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan* [GC], no. 15172/13, § 151, 29 May 2019). Si rregull, masat individuale duhet të jenë në kohë, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të siguruar riparimin sa më të madh të mundshëm për dëmtimet e përcaktuara nga GJEDNJ-ja (po aty, § 170).

Natyra e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja mund të jetë e tillë që nuk lë zgjidhje reale për sa i përket masave të nevojshme për heqjen e saj. Gjykata mund të vendosë të imponojë vetëm një masë të tillë ose ajo masë të nënkuptohet, duke marrë parasysh llojin e shkeljes së konstatuar. Masa të tilla individuale janë, për shembull: kthimi i tokës së shpronësuar,<sup>8</sup> kthimi i ndërtesës,<sup>9</sup> kthimi i banesës që është marrë në mënyrë të paligjshme,<sup>10</sup> lirimi i një

<sup>7</sup> Shih nenin 35 të Neneve mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Veprimet e Paligjshme Ndërkombëtare, të cituar më sipër në fusnotën 2.

<sup>8</sup> Shih *Papamichalopoulos and Others v. Greece* (Article 50), 31 October 1995, § 38, Series A no. 330-B. Detyrimi i shtetit për kthimin e tokës së konfiskuar ishte i përfshirë, si në pjesën operative, ashtu edhe në arsyetimin e aktgjykimit. Meqenëse Greqia nuk e përmbushi detyrimin e tillë për kthimin e tokës, u urdhërua të paguante një shumë të caktuar si zhdëmtim i drejtë. Një detyrim i ngjashëm për kthimin e tokës haset edhe në aktgjykimin *Ramadhi and Others v. Albania*, no. 38222/02, § 102, 13 November 2007.

<sup>9</sup> Shih *Brumarescu v. Romania* (just satisfaction) [GC], no. 28342/95, § 22, ECHR 2001-I; *Hirschhorn v. Romania*, no. 29294/02, § 114, 26 July 2007; dhe *Katz v. Romania*, no. 29739/03, § 42, 20 January 2009. Në këto tre raste, detyrimi për kthimin e një ndërtese është theksuar si në pjesën operative ashtu edhe në arsyetimin e aktgjykimit, ndërsa mos përmbushja e tij ka rezultuar me atë që GJEDNJ-ja i ka urdhëruar shtetet përgjegjëse që të bëjnë pagesën e një shume adekuate si zhdëmtim i drejtë për aplikantët.

<sup>10</sup> *Akimova v. Azerbaijan*, no. 19853/03, 27 September 2007

personi që gjendet në paraburgim,<sup>11</sup> ndërprerja e paraburgimit dhe zëvendësimi i tij me një masë tjetër të arsyeshme dhe më pak të rëndë të privimit nga liria, ose me kombinim të masave të tilla,<sup>12</sup> zëvendësimi i dënimit me burgim të përjetshëm me një dënim në përputhje me Konventën,<sup>13</sup> sigurimi i kushteve adekuate për paraburgim të aplikantit në një institucion që mund t'i sigurojë atij trajtimin e nevojshëm psikiatrik dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme mjekësore,<sup>14</sup> eliminimi i çdo pasoje negative, qoftë të kaluara ose të ardhshme, që rezultojnë nga dënimi disiplinor,<sup>15</sup> fshirja e dënimit për shpifje të shprehur me shkrim nga evidenca penale e aplikantit dhe zhvendëtimi i gjobës së paguar pas përcaktimit të ndërhyrjes jo proporcionale në lirinë e tij të shprehjes,<sup>16</sup> hapja e një hetimi të ri penal<sup>17</sup> ose mbyllja e hetimit aktual,<sup>18</sup> shkatërrimi i të dhënave personale në rast të mbledhjes së paligjshme të të dhënave personale mjekësore të aplikantit nga policia,<sup>19</sup> rivendosja e marrëdhënieve midis prindit dhe fëmijës me të cilin ai nuk jeton, pas shkurorëzimit,<sup>20</sup> lejimi i një komuniteti fetar ose grupi religjioz, regjistrimi i të cilit është refuzuar, që të ketë mundësi për një procedurë të re regjistrimi,<sup>21</sup> shqyrtimi i kërkesës për azil dhe përmbajtja nga dëbimi i një personi të caktuar,<sup>22</sup> marrja e garancive nga autoritetet e një vendi të tretë se aplikantët nuk do t'i nënshtrohen trajtimit që është i papajtueshëm me nenin 3 të Konventës (ndalimi i torturës) ose nuk do të riadhesohen arbitrarisht,<sup>23</sup> gjegjësisht se aplikanti nuk do t'i nënshtrohet

dënimet me vdekje<sup>24</sup> dhe kthimi i një personi në funksionin e tij shtetëror pas shkarkimit arbitrar të tij.<sup>25</sup>

## II.2. Përsëritja e procedurave si një formë e *restitutio in integrum*

Për sa i përket përsëritjes së procedurës si formë e kthimit, ajo mund të merret në konsideratë, varësisht nga lloji i shkeljes së Konventës, vetëm nëse me atë mund të arrihet eliminimi i shkeljes së konstatuar. Faktor kryesor (por sigurisht jo i vetmi) në vlerësimin nëse një procedurë gjyqësore vendore duhet të përsëritet në bazë të një aktgjykimi të GJEDNJ-së, me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së, është nëse kjo shkelje e KEDNJ-së mund të korrigjohet duke e përsëritur procedurën kontestuese. Me këtë rast, është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se **përsëritja e procedurave gjyqësore vendore, megjithatë, nuk duhet të kuptohet si e detyrueshme** nëse gjykatat vendore ofrojnë arsye të mjaftueshme dhe racionale për refuzimin e kërkesës për përsëritjen e asaj procedure.

Kur bëhet fjalë për llojin e shkeljes që është bazë për përsëritjen, përsëritja e procedurës më së shpeshti rekomandohet me rastin e konstatimit të shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 i KEDNJ-së, me ç' rast mund të bëhet fjalë për ndonjërin nga shkeljet në vijim: shkelja e të drejtës për qasje në gjykatë, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e përcaktuar me ligj, parimi i paanshmërisë ose pavarësisë së gjykatës, e drejta për të marrë pjesë në gjykim, e drejta për t'i pyetur dëshmitarët, e drejta për t'u marrë në pyetje personalisht, e drejta për t'u informuar për aktakuzën, e drejta për të pasur kohë dhe mundësi për të përgatitur mbrojtjen, parimi i procedurës kundërshtuese dhe barazia e armëve, e drejta për ndihmë juridike, ndalimi i nxitjes policore dhe e drejta për aktgjykim të arsyetuar. Është e kuptueshme se pasojat e devijimit nga parimi i gjykimit nuk mund të korrigjohen brenda një afati të arsyeshëm me rigjykim, prandaj në shkelje të tilla të nenit 6 nuk ka nevojë të përsëritet procedura gjyqësore në fjalë.

Gjithashtu duhet theksuar se përveç shkeljeve të nenit 6 të KEDNJ-së, mundësia e përsëritjes së procedurës gjyqësore nuk përjashtohet plotësisht dhe ajo është marrë në konsideratë edhe për shkelje të të drejtave dhe lirive të tjera nga Konventa, ndërsa ekzistenca reale e nevojës për përsëritje duhet të vlerësohet varësisht nga rrethanat e rastit të caktuar dhe nga lloji i shkeljes së konstatuar. Në këtë kuptim, Gjykata ka vendosur nëse do të ishte e përshtatshme të përsëritej procedura përkatëse, me ç' rast ose ka rekomanduar përsëritje ose e ka refuzuar kategorikisht atë.

Një shembull ilustrues është lënda *Verein gegen Tierfabriken VgT* (no. 2), në të cilën u konstatua

<sup>11</sup> Shih *Assanidze v. Georgia* [GC], no. 71503/01, § 203, KEDNJ 2004-II dhe pika 14 (a) e pjesës operative. Në këtë aktgjykim, GJEDNJ-ja, duke iu referuar nenit 41 të KEDNJ-së, vendosi detyrimin për lirinë e aplikantit "sa më shpejt të jetë e mundur". Për situata të ngjashme, shih edhe *Ilascu and Others v. Moldova and Russia* [GC], no. 48787/99, § 490, KEDNJ 2004-VII, si dhe pika 22 e pjesës operative; *Fatullayev v. Azerbaijan*, no. 40984/07, § 177, 22 April 2010, pastaj pika 6 e pjesës operative; *Del Rio Prada v. Spain* [GC], no. 42750/09, § 138, KEDNJ 2013 dhe pika 3 e pjesës operative. Në dy rastet e fundit, detyrimi ishte vendosur sipas nenit 46 të KEDNJ-së.

<sup>12</sup> Shih *Aleksanyan v. Russia*, no. 46468/06, § 239, 22 December 2008. Detyrimi për zëvendësimin e masës së paraburgimit të parashikuar në arsyetimin e këtij aktgjykimi sipas nenit 46 ishte përfshirë edhe në pikën 9 të pjesës operative të aktgjykimit.

<sup>13</sup> Shih *Scoppola v. Italy* (no. 2) [GC], no. 10249/03, § 154, 17 September 2009. Detyrimi për ekzekutimin e këtij aktgjykimi sipas nenit 46 përmendet edhe në pikën 6 (a) të pjesës operative të aktgjykimit.

<sup>14</sup> *Stawomir Musiał v. Poland*, no. 28300/06, 20 January 2009. Gjithashtu, në rast të ekzistimit të kushteve joadekuate të burgimit të aplikantit dhe trajtimit të papërshtatshëm mjekësor, aplikanti është transferuar në një institucion të specializuar për të burgosurit që vuajnë nga sëmundje të caktuara mendore, ku ai merr trajtim të përditshëm mjekësor dhe këshillim psikiatrik (*Dybeku v. Albania*, no. 41153/06, 18 December 2007).

<sup>15</sup> Shih *Maestri v. Italy* [GC], no. 39748/98, § 47, ECHR 2004-I.

<sup>16</sup> *De Almeida Azevedo v. Portugal*, no. 43924/02, 23 January 2007

<sup>17</sup> Shih *Abuyeva and Others v. Russia*, no. 27065/05, § 243, 2 December 2010 dhe *Benzer and Others v. Turkey*, no. 23502/06, § 219, 12 November 2013.

<sup>18</sup> Shih *Nihayet Arıcı and Others v. Turkey*, nos. 24604/04 and 16855/05, § 176, 23 October 2012.

<sup>19</sup> *L.H. v. Latvia*, no. 52019/07, 29 April 2014

<sup>20</sup> *Mitovi*, nr. 53565/13, aktgjykimi i datës 16 prill 2015 dhe *Olluri*, nr. 3368/18, aktgjykimi i datës 16 janar 2020

<sup>21</sup> *Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Arqipeshkvia Ortodokse Greke e Ohrit në Patriarkanën e Pejës)*, nr. 3532/07, aktgjykimi i datës 16 nëntor 2017 dhe *Komuniteti Bektashian dhe të tjerët*, nr. 48044/10; 75722/12 dhe 25176/13, aktgjykimi i datës 12 prill 2018

<sup>22</sup> Në *M.S.S. v. Belgium and Greece* [GC], no. 30696/09, GJEDNJ 2011, duke i marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit dhe nevojën urgjente për të ndaluar shkeljet e neneve 13 dhe 3 të Konventës, Gjykata ka konsideruar se "Greqia ka detyrimin të veprojë pa vonesë duke e shqyrtuar a është e arsyeshme kërkesa për azil të aplikantit që i plotëson kërkesat e Konventës dhe në pritje të rezultatit të atij shqyrtimi, do të përmbahet nga dëbimi i aplikantit." Megjithatë, asnjë nga këto masa individuale, të cekura sipas nenit 46, nuk është futur në pjesën operative (në shqiptimin) të aktgjykimit.

<sup>23</sup> Shih *Hirsi Jamaa and Others v. Italy* [GC], no. 27765/09, § 211, ECHR 2012

<sup>24</sup> *Al Nashiri v. Poland*, no. 28761/11, 24 July 2014

<sup>25</sup> Shih *Oleksandr Volkov v. Ukraine*, no. 21722/11, § 208, ECHR 2013. Detyrimi i theksuar për kthimin e gjyqtarit të shkarkuar në pozitën e tij "sa më parë të jetë e mundur" përmendet edhe në arsyetimin e aktgjykimit sipas neneve 41 dhe 46 të KEDNJ-së, por edhe në pikën 9 të pjesës operative të aktgjykimit. GJEDNJ-ja i ndjek të njëjtat formulime edhe në praktikën e saj të mëtejshme (si p.sh., shih *Kulykov and Others v. Ukraine*, nos. 5114/09 and 17 others, § 148, 19 January 2017). Ngjashëm: *Mishqjoni v. Albania*, no. 18381/05, 7 December 2010.



shkelje e lirisë së shprehjes, e cila është e mbrojtur me nenin 10 të Konventës, si rezultat i refuzimit të vazhdueshëm nga autoritetet kompetente për të lejuar transmetimin televiziv të një reklame të përgatitur nga një shoqatë për mbrojtjen e kafshëve, e cila paraqitet si aplikant, përkundër shkeljes së konstatuar të nenit 10 në aktgjykimin e mëparshëm të Gjykatës.<sup>26</sup> Më konkretisht, shkelja e përsëritur e këtij neni është shkaktuar nga refuzimi i Gjykatës Federale të Zvicrës për të vepruar sipas kërkesës së aplikantit për të përsëritur procedurën kontestuese në të cilën u vendos për kërkesën e tij për transmetimin e reklamës. Prandaj, ky rast nuk i referohet përsëritjes së procedurës për shkeljen e konstatuar të nenit 6 të Konventës, por për refuzimin e rishqyrtimit të ndalimit të transmetimit të reklamës televizive dhe rrjedhimisht të nenit 10 të Konventës.

Aktgjykimi *Verein gegen Tierfabriken VgT* (no. 2) është gjithashtu i rëndësishëm sepse ripohon se rihapja e procedurës vendore është një aspekt i rëndësishëm i ekzekutimit të aktgjyqimeve të Gjykatës dhe se kjo duhet të bëhet në përputhje me “përfundimet dhe frymën e aktgjykimit të Gjykatës që ekzekutohet” dhe të jetë “në përputhje me garancitë procedurale nga Konventa.” Njëkohësisht theksohet veçanërisht se përsëritja e procedurës në të cilën është shkelur Konventa **nuk është qëllim në vete, por vetëm mjet**, edhe atë mjet kryesor, i cili përdoret për një qëllim të caktuar – për të siguruar ekzekutimin e plotë dhe adekuat të aktgjyqimeve të Gjykatës.<sup>27</sup>

Gjykata e ka shqyrtuar edhe çështjen e përsëritjes së procedurave gjyqësore edhe në rastet kur është konstatuar shkelje e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës (ndalimi i gjyqimit ose dënimit të dyfishtë), me ç’ rast ajo vuri në dukje se në rrethanat e veçanta të rastit konkret, nuk kishte asnjë detyrim për shtetin që ishte përgjegjës për ta rihapur ndonjëherë nga procedurat e kontestuara (për shembull, në *Tsonyo Tsonev v. Bulgaria* (no. 4), no. 35623/11, §§ 62-66, 6 April 2021).

Gjithashtu, në një lëndë në të cilën u konstatua shkelje e nenit 5 paragrafi 5 të KEDNJ-së, nga këndvështrimi i së drejtës për zhdëmtim në rast të privimit të pabazë nga liria, Gjykata arriti në përfundimin se do të përbente një barrë jo proporcionale për aplikantin që të kërkojë përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore për kompensimin e dëmit.<sup>28</sup>

Përkundrazi, në rastet kur shkelja e konstatuar e ka prekur të drejtën e pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, Gjykata ka theksuar mundësinë që ka qenë në dispozicion të aplikantëve për të kërkuar përsëritjen e procedurave në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit vendor, gjë që do t’u mundësonte rishqyrtim të pretendimeve të tyre pronësore-juridike. *Bistrović v. Croatia*, no. 25774/05, § 58, 31 maj 2007 dhe *Strežovski dhe të tjerët*, nr. 14460/16 dhe 7 aplikime të tjera, aktgjykimi i datës 27 shkurt 2020, paragrafi 95).<sup>29</sup>

<sup>26</sup> *VgT Verein gegen Tierfabriken v. Switzerland*, no. 24699/94, § 75, ECHR 2001-VI

<sup>27</sup> *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2) [GC], no. 32772/02, § 90, ECHR 2009

<sup>28</sup> *Velinov*, nr. 16880/08, aktgjykimi i datës 19 shtator 2013, paragrafi 74.

<sup>29</sup> Në rastin *Strežovski dhe të tjerët* GJEDNJ-ja udhëzoi përsëritjen e procedurave të kontestuara vendore, pasi edhe vetë mori qëndrim se nuk është në gjendje ta vlerësojë kërkesën e aplikantëve për kompensimin e dëmit material.

### II.3. Rekomandimi nr. R (2000) 2 i Këshillit të Evropës për rishqyrtimin ose rihapjen e procedurës gjyqësore për raste të caktuara në nivel nacional pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Praktika e Komitetit të Ministrave ndikon në vendosjen e standardeve të përgjithshme nëpërmjet miratimit të rekomandimeve të Komitetit që lidhen me procesin e ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së. Ndër të tjera, i tillë është edhe Rekomandimi nr. R (2000) 2 për rishqyrtimin ose rihapjen e procedurave gjyqësore për raste të caktuara në nivel nacional pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “Rekomandimi nr. R (2000) 2”).<sup>30</sup> Në aktgjykimet e saj, GJEDNJ-ja shpesh mbështetet pikërisht në standardet e këtij Rekomandimi si pikënisje në arsyetimin e saj në lidhje me çështjen e përsëritjes së proceseve gjyqësore vendore që kanë rezultuar me shkeljen e lirisë dhe të drejtave të Konventës.

Në Rekomandimin nr. R (2000) 2 Komiteti i Ministrave vë në dukje se në përputhje me praktikën e mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjyqimeve të Gjykatës, rishqyrtimi i një rasti ose rihapja e procedurave, në disa rrethana të jashtëzakonshme, është dëshmuar të jetë **mjeti më efektiv, nëse jo edhe i vetmi, për të arritur *restitutio in integrum***. Prandaj, Komiteti i Ministrave u bën thirrje shteteve të vendosin mekanizma për rishqyrtimin e rastit pas konstatimit të shkeljes së Konventës nga ana e Gjykatës, duke përfshirë edhe mekanizmin për rihapjen e procedurave gjyqësore, veçanërisht kur:

- i. *Pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja të rënda negative për shkak të rezultatit të vendimit nacional, të cilat nuk janë korrigjuar në mënyrë adekuate me zhdëmtim të drejtë dhe nuk mund të korrigjohen përveç se me rishqyrtimin e rastit dhe rihapjen e procedurës gjyqësore, dhe*
- ii. *Aktgjykimi i Gjykatës çon në përfundimin në vijim:*
  - a. *vendimi nacional i kontestuar është (në thelb) me të drejtë në kundërshtim me Konventën, ose*
  - b. *shkelja e konstatuar bazohet në gabime ose mangësi të rënda procedurale që janë të një rëndësie të tillë që të ngrenë dyshime serioze mbi rezultatit e procedurave nacionale që janë kontestuar.”*

Prandaj, rihapja e lëndës është e pranueshme vetëm nëse plotësohen dy kushtet kumulative: **1) ekzistenca e vuajtjeve të vazhdueshme, gjegjësisht vuajtja e pasojave negative shumë të rënda dhe 2) pamundësia për t’i korrigjuar këto pasoja me anë të zhdëmtimit të drejtë.**

Kushti i parë thelbësor që duhet të plotësohet për të përsëritur procedurën gjyqësore është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e **shkeljes materiale të KEDNJ-së**. Në fakt, viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut duhet të pësojnë ende pasoja shumë të rënda negative nga shkelja në momentin kur Gjykata e konstaton shkeljen dhe këto pasoja duhet të jetë e mundur të hiqen, gjegjësisht të korrigjohen vetëm me përsëritjen e procedurës.

<sup>30</sup> Miratuar më 19 janar 2000 në mbledhjen e 694-të të Zëvendësministrave. Teksti i plotë i këtij aktgjykimi, me përkthim në gjuhën maqedonase, gjendet në aneksin e këtij publikimi.

Kur është fjala për **shkelje procedurale të KEDNJ-së** gjegjësisht kur me aktgjykim të Gjykatës është konstatuar një gabim apo mangësi procedurale, përsëritja e procedurës do të varet nga pesha e gabimit, gjegjësisht mangësisë, si dhe nga serioziteti i dyshimit për rezultatin e procedurës vendore. Në rast të shkeljeve procedurale të Konventës, përsëritja e procedurës penale të kontestuar mund të çojë në lirimin e aplikantit, por kjo mund të rezultojë edhe në konfirmimin e aktgjykimit të marrë më parë. Kjo tregon se posa të aprovohet kërkesa për përsëritjen e procedurës kontestuese, shteti do të ketë **detyrim mjjetesh, e jo detyrim rezultati** në kuptim të përcaktimit paraprak të rezultatit të procedurës së përsëritur. Prandaj, nëse konfirmohet aktgjykimi i miratuar më parë, i cili është kontestuar në Gjykatën e Strasburgut, është thelbësore që ai aktgjykim të jetë konfirmuar në një procedurë që është zbatuar duke i respektuar plotësisht të gjitha garancitë për një procedurë të drejtë gjyqësore.

Vetë kërkesa për “vuajtjen e vazhdueshme” nënkupton ekzistencën e “një lidhjeje të drejtpërdrejtë shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe vuajtjes së vazhdueshme të palës së dëmtuar”, si dhe ekzistencën e “pasojave negative shumë të rënda si rezultat i rezultatit të vendimit nacional” për të cilin bëhet fjalë.<sup>31</sup> Në këtë kuptim, duke marrë parasysh se kur shkelja e Konventës kryhet në procedurë penale, kjo mund të ndikojë në ndëshkimin ose dënimin, ndërsa kthimi i aplikantit në situatën në të cilën ka qenë, nëse shkelja nuk do të kishte ndodhur, mund të nënkuptojë: përsëritja e procedurës gjyqësore të përfshijë edhe rishikimin si të ndëshkimit ashtu edhe të dënimit ose vetëm të dënimit, pavarësisht nga ashpërsia e tij. Nga ana tjetër, kërkesa për “vuajtjen e vazhdueshme” bie ndesh me logjikën e mjetit të jashtëzakonshëm juridik përmes të cilit paraqitet propozimi, gjegjësisht kërkesa për rihapjen e procedurës vendore, duke pasur parasysh se në shumicën e shteteve rihapja e rastit lejohet edhe pas vuajtjes së dënimit me burg ose pasi i dënuari ka vdekur.

Përndryshe, neni 4 paragrafi 2 i Protokollit nr. 7 i Konventës, përcakton kushte paksa të ndryshme që duhet të zbatohen për çdo rihapje të rasteve, gjegjësisht, përsëritje të proceseve gjyqësore vendore në krahasim me kriteret e renditura në Rekomandimin nr. R (2000) 2. Në fakt, me nenin 4 paragrafi 1 i Protokollit nr. 7 vendoset ndalimi për gjykim të dyfishtë ose dënim të dyfishtë, kur thuhet se “askush nuk mund të nxirret para gjykatës ose të dënohet përsëri në një procedurë penale nga një gjykatë e të njëjtit shtet, për një vepër për të cilën tashmë është shpallur i pafajshëm me aktgjykim të plotfuqishëm ose është dënuar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti.” Në paragrafin 2 të kësaj dispozite thuhet se “dispozitat e paragrafit paraprak nuk e pengojnë rihapjen e lëndës në pajtim me ligjin dhe procedurën penale të shtetit për të cilin bëhet fjalë, nëse ka prova për fakte të reja ose fakte të zbuluara shtesë, ose nëse ka pasur ndonjë lëshim thelbësor në procedurën e mëparshme, i cili ka mundur të ndikojë në aktgjykimin e marrë.”

Kushti tashmë i përmendur në Rekomandimin nr. R (2000) 2 për rihapjen e proceseve gjyqësore vendore pas aktgjykimit të GJEDNJ-së - pasojat e rënda negative të shkeljes “të mos mund të eliminohen në mënyrë adekuate me zhdëmtim të drejtë dhe (të) mos mund

<sup>31</sup> Për shembull, në kontekstin e procedurave penale, si “pasoja negative shumë të rënda” mund të konsiderohen: regjistrimi i dënimit të personit të dënuar në dosjen penale, detyrimi për të paguar një gjobë të konsiderueshme, ekspozimi i personit të dënuar ndaj kufizimeve në jetën e tij shoqërore dhe profesionale, pavarësisht nëse këto kufizime janë rezultat i shqiptimit të dënimit me kusht, ose i lirit me kusht.

të korrigjohen ndryshe përveçse duke e rishqyrtuar rastin dhe me rifillimin e procedurës gjyqësore”, përcakton një **raport të caktuar të përparësisë ndërmjet rihapjes së procedurës vendore dhe zhdëmtimit të drejtë**, që nënkupton se sa herë që është e mundur, përparësi duhet t'i jepet zhdëmtimit të drejtë në krahasim me rihapjen e procedurës vendore dhe vetëm nëse kompensimi i drejtë është i pamjaftueshëm për të korrigjuar dëmin, duhet të përsëritet procedura përkatëse.

Nga ana tjetër, konsiderohet se, në fund të fundit, shteti përgjegjës për shkeljen duhet të veprojë në mënyrën më të përshtatshme të mundshme për të siguruar riparim të plotë, në vend të zhdëmtimit të pjesshëm për shkeljen e konstatuar të Konventës. Për këtë qëllim është e dëshirueshme të arrihet *restitutio in integrum*, që nënkupton eliminimin e pasojave juridike dhe materiale të veprimit të tij të paligjshëm duke e rikthyer situatën që do të kishte ekzistuar nëse ai veprim nuk do të ishte kryer, gjë që mund të arrihet vetëm duke e rihapur procedurën vendore që ka çuar në atë veprim të kundërligjshëm. Prandaj, zhdëmtimi i drejtë mund t'i shtohet rikthimit në masën në të cilën dëmi nuk mund të korrigjohet plotësisht me rikthimin, por të mos parashikohet si alternativë, ose aq më pak, si alternativë e dëshirueshme ndaj rikthimit.

#### II.4. Klauzola e rigjykimit

Në parim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ka juridiksion të qartë për të urdhëruar një shtet të rigjykojë ose të rihapë një rast të caktuar (shih, për shembull, *Saïdi v. France*, 20 September 1993, § 47, Series A no. 261-C, и *Pelladoah v. the Netherlands*, 22 September 1994, § 44, Series A no. 297-B). Megjithatë, gradualisht është zhvilluar praktika gjyqësore në ato aktgjyqime në të cilat konstatohet se nuk janë përmbushur kërkesat për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës, GJEDNJ-ja të theksojë se rigjykimi ose rihapja e lëndës, nëse kërkohet, në parim, përbën mënyrën më të përshtatshme për eliminimin e shkeljes, që është në përputhje me Rekomandimin nr. R (2000) 2, sipas të cilit këto masa përfaqësojnë “mjetin më efektiv, nëse jo edhe të vetmin, për të arritur *restitutio in integrum*.”<sup>32</sup>

Përndryshe, detyrimet për ndërmarrjen e masave individuale për ekzekutimin e aktgjykimit, duke përfshirë edhe përsëritjen e procedurave gjyqësore vendore, mund të shqiptohen në pjesën operative (dispozitivin) e aktgjykimit.<sup>33</sup> ose të përfshihen në arsyetimin e aktgjykimit

<sup>32</sup> *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2) [GC], n.o. 32772/02, § 89, ECHR 2009

<sup>33</sup> I tillë është, për shembull: detyrimi për të prodhuar një efekt real konkret “sa më shpejt të jetë e mundur” ose “menjëherë” (si në aktgjykimin *Assanidze v. Georgia* [GC], no. 71503/01, ECHR 2004-II); detyrimi për të anuluar, gjegjësisht për të shfuqizuar aktgjykimin vendor të kontestuar dhe për të prodhuar një efekt juridik specifik që paraqet “formën më të përshtatshme të dëmshpërblimit” brenda një periudhe të caktuar, si p.sh. tre muaj nga data në të cilën aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm (si në aktgjykimin *Gladysheva v. Russia*, no. 7097/10, 6 December 2011) dhe detyrimi për të ekzekutuar vendimin e gjykatës vendore dhe për të prodhuar efektin e tij real brenda një periudhe të caktuar kohore (si në aktgjykimet *Plotnikov v. Russia*, no. 43883/02, 24 February 2005 dhe *Gluhaković v. Croatia*, no. 21188/09, 12 April 2011).

të GJEDNJ-së.<sup>34</sup>

Në traditën e gjatë të Gjykatës, detyrimet për marrjen e masave individuale për ekzekutimin e aktgjyqimit që janë shqiptuar në pjesën operative (dispozitivin) e aktgjyqimit, si dhe ato detyrime që janë të përfshira në arsyetimin e aktgjyqimit, kanë të njëjtën fuqi juridike. Megjithatë, një mjet kyç për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës mbetet klauzola e rigjyqimit, fuqia juridike e së cilës nuk varet nga fakti nëse është futur në arsyetim ose në pjesën operative (dispozitivin) të aktgjyqimit.

Me këtë rast, në aktgjyqimet e saj GJEDNJ-ja përdor formulime të ndryshme përmes të cilave e shpreh pritshmërinë që shteti përgjegjës të bëjë përsëritjen e procedurës së kontestuar gjyqësore vendore si masë individuale për zbatimin e një aktgjyqimi të caktuar.

Kështu, klauzola e rigjyqimit, e njohur edhe si “klauzola *Gençel*”, u formulua për herë të parë në kontekstin specifik të lëndëve kundër Turqisë që kishin të bëjnë me mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave nacionale të sigurisë. Në këto lëndë, Gjykata theksoi se sipas nenit 41 të Konventës “në parim, forma më e përshtatshme e dëmtshpërblimit për aplikantin do të ishte t’i jepej atij një rigjykim pa vonesë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.<sup>35</sup>

Më vonë, kjo klauzolë u bë e njohur si “klauzola *Gençel-Somogyi*”, pasi një pikëpamje e ngjashme u miratua nga GJEDNJ-ja në bazë të nenit 41 edhe në një lëndë kundër Italisë, ku shkelja e garancive për gjykim të drejtë kishte të bënte me të drejtën e aplikantit për të marrë pjesë në gjykim.<sup>36</sup> Siç u përmend më lart, në të dyja rastet kjo klauzolë ishte pjesë përbërëse e arsyetimit të aktgjyqimeve.

Në *Öçalan v. Turkey*, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstatoi se kur një individ dënohet nga një gjykatë që nuk i ka plotësuar kërkesat e pavarësisë dhe paanshmërisë, “rigjyqimi ose rihapja e lëndës, nëse kërkohet, është, në parim, mjeti më i përshtatshëm për të korrigjuar shkeljen.” (formulimi i njohur si “klauzola *Öçalan*”). Për më tepër, masat konkrete për të korrigjuar shkeljen që i kërkohen shtetit që konsiderohet përgjegjës për shkeljen në mënyrë që ai t’i përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 46 të Konventës, do të varen nga rrethanat e veçanta

<sup>34</sup> Për shembull, detyrimi për të marrë një vendim gjyqësor vendor “pa vonesë”, “i cili i plotëson kërkesat e Konventës” dhe shteti të përmbahet nga çdo veprim derisa të merret një vendim i tillë (aktgjyqimi në *M.S.S v. Belgium and Greece* [GC], no. 30696/09, ECHR 2011); detyrimi për të ndërmarrë një masë konkrete individuale, e cila është “e pashmangshme” dhe “duhet të përcaktohet” në përputhje me kritere të përcaktuara në aktgjykimin e Gjykatës (*Abuyeva and Others v. Russia*, no. 27065/05, 2 December 2010); detyrimi për të ndërmarrë një masë konkrete individuale në përputhje me masat e përgjithshme të nevojshme për zbatimin e saj pa asnjë afat (*Laska and Lika v. Albania*, nos. 12315/04 and 17605/04, 20 April 2010); detyrimi për të ndërmarrë një masë konkrete individuale që “përfaqëson zhdëmtimin më të përshtatshëm në rrethanat e rastit” (*Voitechová v. Slovakia*, no. 59102/08, 25 September 2012); detyrimi për të ndërmarrë një masë konkrete individuale, e cila në parim është “forma më e përshtatshme e zhdëmtimit” (*Gençel v. Turkey*, no. 53431/99, 23 October 2003 dhe *Somogyi v. Italy*, no. 67972/01, ECHR 2004-IV); detyrimi për të ndërmarrë një masë konkrete individuale, e cila “nëse është e nevojshme, përfaqëson, në parim, mënyrën më të përshtatshme të eliminimit të shkeljes” (*Öçalan v. Turkey* [GC], no. 46221/99, ECHR 2005-IV dhe *Sejdovic v. Italy* [GC], no. 56581/00, ECHR 2006-II). Në të njëjtën kohë, në arsyetim, GJEDNJ-ja ndonjëherë i referohet mundësisë (së nënkuptuar) për të përdorur mjetet juridike vendore për rishikimin (e jashtëzakonshëm) të aktgjyqimeve.

<sup>35</sup> *Gençel v. Turkey*, no. 53431/99, § 27, 23 October 2003

<sup>36</sup> *Somogyi v. Italy*, no. 67972/01, §..., ECHR 2004-IV

të rastit individual dhe duhet të përcaktohen në dritën e kushteve nga aktgjykimi i Gjykatës në atë rast, me vëmendjen e duhur ndaj praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.<sup>37</sup>

Në disa nga rastet në të cilat klauzola e rigjyqimit është futur në pjesën operative (dispozitivin) të aktgjyqimit, si për shembull në rastin *Lungoci*<sup>38</sup>, Gjykata urdhëroi që shteti përgjegjës të rihapte procedurën vendore në afat prej gjashtë muajsh nga data në të cilën aktgjyqimi është bërë i plotfuqishëm, nëse aplikanti e kërkon këtë.

Në lëndën *Laska and Lika v. Albania*<sup>39</sup>, GJEDNJ-ja shkoi një hap më tej për të përcaktuar se në bazë të nenit 46 ekziston një detyrim pozitiv për shtetin përgjegjës “të heqë çdo pengesë në sistemin ligjor vendor që mund të pengojë që situata e aplikantit të korrigjohet në mënyrë adekuate (...) ose të fusë në përdorim mjet të ri” për rihapjen e lëndëve, e si rezultat i mungesës së një mjeti të tillë në legjislacionin nacional. Më konkretisht, në atë aktgjykim, GJEDNJ-ja nuk u përmbajt të përsëriste se shtetet anëtare të Konventës janë të detyruara t’i organizojnë sistemet e tyre të drejtësisë në atë mënyrë që do t’u mundësojë gjykatave të tyre t’i përmbushin kërkesat e Konventës, me ç’ rast ka theksuar se ky parim vlen si për rihapjen e procedurave ashtu edhe për rishqyrtimin e lëndëve të aplikantëve.

Praktika e GJEDNJ-së është e ndryshme për sa i përket **akumulimit të zhdëmtimit të drejtë dhe klauzolës së rigjyqimit**. Kështu, për dallim nga aktgjyqimet *Gençel* dhe *Öçalan* në të cilat nuk jepet zhdëmtimi i drejtë, në shumicën e rasteve, GJEDNJ-ja jep në mënyrë kumulative zhdëmtim të drejtë dhe vë në dukje mundësinë për rigjykim. Më rrallë, ajo e refuzon kërkesën për zhdëmtim të drejtë për shkak të përcaktimit të rigjyqimit. Përndryshe, GJEDNJ-ja më së shumti i referohet ekzistimit të një mekanizmi nacional për rishqyrtimin e aktgjyqimit vendor, ndonjëherë si plotësim i zhdëmtimit të drejtë të dhënë, e ndonjëherë në mungesë të tij.

Nga ana tjetër, në disa aktgjyqime të saj, GJEDNJ-ja e hodhi poshtë shprehimisht mundësinë e përsëritjes së procedurës së kontestuar të përfunduar në mënyrë të plotfuqishme, pasi konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me të (*Henryk Urban dhe Ryszard Urban v. Poland*, no. 23614/08, § 66, 30 November 2010; *Moreira Ferreira v. Portugal* (no. 2) [GC], no. 19867/12, §§ 49 and 51, 11 July 2017, si dhe *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], 26374/18, §§ 311-314, 1 December 2020).

Konkretisht, në *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], Gjykata deklaroi se në disa rrethana specifike e konsideron të dobishme t’i vë në dukje shtetit që është përgjegjës për shkeljen, llojin e masave që mund të ndërmerren për t’i dhënë fund situatës së caktuar që ka çuar në konstatimin e shkeljes, gjë që shpesh ndodh kur bëhet fjalë për një situatë me karakter sistemor.<sup>40</sup> Në të njëjtën kohë, megjithëse bëhej fjalë për një shkelje që i referohej një problemi sistemor, për sa i përket faktit nëse gjykata ishte themeluar në bazë

<sup>37</sup> *Öçalan v. Turkey* [GC], no. 46221/99, § 210, ECHR 2005-IV

<sup>38</sup> *Lungoci v. Romania*, no. 62710/00, 26 January 2006

<sup>39</sup> *Laska and Lika v. Albania*, nos. 12315/04 and 17605/04, 20 April 2010

<sup>40</sup> *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], 26374/18, § 312, 1 December 2020

të ligjit, e duke marrë parasysh mënyrën se si u emëruan disa nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të sapokrijuar në Islandë, GJEDNJ-ja, megjithatë, mori qëndrimin se është detyrim i shtetit përgjegjës që vetë t'i zgjedhë masat e përgjithshme që janë të përshtatshme për t'i zgjidhur problemet (sistemo) që çuan në gjetjet e Gjykatës dhe për të parandaluar që shkelje të ngjashme të ndodhin në të ardhmen. Për më tepër, Gjykata theksoi se konstatimi i shkeljes në rastin konkret, në vetvete, nuk mund të merret si bazë për t'i vendosur shtetit përgjegjës detyrimin për t'i rihapur të gjitha rastet e ngjashme, të cilat ndërkohe janë bërë *res judicata* sipas legjislacionit të vendit.<sup>41</sup> Përndryshe, ky rast konkret padyshim ka një specifikë interesante, sepse bëhet fjalë për një lloj mbivendosje të masës për përsëritjen e procedurave vendore, e cila njëkohësisht paraqitet edhe si masë e përgjithshme edhe si masë individuale për ekzekutim.

<sup>41</sup> *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], 26374/18, § 314, 1 December 2020

### III. Aspektet specifike të përsëritjes së proceseve gjyqësore vendore përmes prizmit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

#### III.1. Procedura pas kërkesës për përsëritjen e proceseve gjyqësore vendore pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si bazë për një procedurë të re para GJEDNJ-së

##### III.1.1. Çështjet që lidhen me pranimin e kërkesave të reja para GJEDNJ-së

Siç u përmend më lartë, ekzekutimi i aktgjyimeve të GJEDNJ-së është jashtë juridiksionit të GJEDNJ-së, me përjashtim të rastit kur inicohet “procedura e shkeljes”, e parashikuar në nenin 46 paragrafi 4 dhe 5 të KEDNJ-së, kurse në bazë të nenit 46 paragrafi 2 të GJEDNJ-së, roli i mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e aktgjyimeve i takon kryesisht Komitetit të Ministrave. Megjithatë, një rol i tillë i Komisionit nuk e pengon GJEDNJ-në që të veprojë në lidhje me kërkesat (aplikimet) e reja të shkaktuara nga masat e marra nga shteti në procesin e ekzekutimit të aktgjykimit të marrë më parë nga GJEDNJ-ja, me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së, nëse ajo kërkesë përmban informacione të reja relevante në lidhje me çështjet që nuk i nënshtroheshin vlerësimit gjatë marrjes së aktgjykimit fillestar me të cilin GJEDNJ-ja ka konstatuar më parë shkelje të KEDNJ-së (shih *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no.2) [GC], no. 32772/02, §§ 61-63, ECHR 2009).

Masat e marra nga shteti për korrigjimin e shkeljes së konstatuar të KEDNJ-së, të cilat ngrenë një çështje të re për të cilën GJEDNJ-ja nuk ka vendosur me aktgjykimin fillestar, janë në juridiksionin e KEDNJ-së dhe mund të jenë lëndë e një aplikimi të ri, të cilin mund ta shqyrtojë GJEDNJ-ja (*Guja v. Republic of Moldavia* (no. 2), no. 1085/10, § 35, 27 February 2018). Fakti që mbikëqyrja nga Komiteti i Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e aktgjykimit është ende në rrjedhë e sipër, nuk e pengon GJEDNJ-në që të veprojë në lidhje me një aplikim të ri, nëse ai përfshin aspekte të reja që nuk janë shqyrtuar dhe vendosur në kohën kur është marrë aktgjykimi inicial. (*Moreira Ferreira v. Portugal* (no. 2) [GC], no. 19867/12, § 57, 11 July 2017).

Në kontekst të pranimit të aplikimit të ri, duhet të merren parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore në lidhje me nenin 35 paragrafi 2 (b) të KEDNJ-së, sipas të cilit aplikimi duhet të shpallet i papranueshëm nëse në thelb është i njëjtë si çështja që tashmë

është shqyrtuar nga Gjykata... dhe nuk përmban asnjë informacion të ri relevant.<sup>42</sup> Prandaj, GJEDNJ-ja duhet të përcaktojë nëse dy aplikimet që i janë parashtruar i referohen në thelb të njëjtë person, të njëjtave fakte dhe të njëjtave pretendime të ankesës (*Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2) [GC], no. 32772/02, § 63, ECHR 2009).

Vetë koncepti i pretendimeve të anketës karakterizohet nga faktet që janë theksuar në të, e jo vetëm nga bazat ligjore në të cilat bazohet (shih *Guerra and Others v. Italy*, 19 February 1998, § 44, Reports 1998-I dhe *Powell and Rayner v. the United Kingdom*, 21 February 1990, § 29, Series A no. 172). Në të njëjtën kohë, GJEDNJ-ja mori qëndrimin se sa herë që aplikanti dorëzon informacion të ri, aplikimi nuk do të jetë në thelb i njëjtë me aplikimin e mëparshëm (shih *Patera v. the Czech Republic* (dec.), no. 25326/03, Commission decision of 10 January 1996 i *Chappex v. Switzerland* (dec.), no. 20338/92, Commission decision of 12 October 1994).

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përcaktimi i ekzistencës së mundshme të një “çështjeje të re” varet kryesisht nga rrethanat specifike të rastit konkret, ndërsa dallimet midis rasteve nuk janë gjithmonë të qarta. Kështu, për shembull, në *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2)<sup>43</sup> GJEDNJ-ja konstatoi se ishte kompetente të shqyrtonte pretendimin e ankesës në lidhje me refuzimin e gjykatës vendore për ta përsëritur procedurën pas aktgjykimit të GJEDNJ-së. Në parim, GJEDNJ-ja iu referua faktit se arsytet për refuzimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës ishin të reja dhe për këtë arsye përfaqësonin informacion të ri relevant që mund të ishte arsye për konstatimin e një shkeljeje të re të KEDNJ-së (po aty., § 65).

Në këtë lëndë, Gjykata vuri në dukje se kompetencat e Komitetit të Ministrave nga neni 46 i KEDNJ-së nuk e cenojnë kompetencën e GJEDNJ-së për të vepruar mbi informacione të reja relevante në kontekstin e një aplikimi të ri me pretendime për shkelje të GJEDNJ-së. Në të njëjtën kohë, Gjykata në fakt, vendosi kompetencën faktike për të shqyrtuar sjelljen e autoriteteve vendore pas miratimit të aktgjykimit të parë të GJEDNJ-së në rastin *Verein gegen Tierfabriken (VgT)*<sup>44</sup>, duke argumentuar se nëse ajo nuk ka qenë në gjendje ta bënte këtë, ky aktgjykim do të kishte shkuar përtej mbikëqyrjes së Konventës. Në fakt, GJEDNJ-ja në vendimin e saj ka marrë parasysh faktin se Komiteti i Ministrave e ka përfunduar mbikëqyrjen e tij mbi ekzekutimin e aktgjykimit të GJEDNJ-së pa qenë në dijeni të refuzimit të përsëritjes së procedurës së kontestuar, pasi KM-ja nuk ishte e informuar për një vendim të tillë të Gjykatës Federale të Zvicrës, i cili u miratua pasi KM-ja e miratoi një rezolutë për mbylljen e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e aktgjykimit të parë. GJEDNJ-ja konsideroi se për këtë arsye, refuzimi i kontestuar për të përsëritur procedurën përfaqëson një fakt të ri.<sup>45</sup> (po aty., § 65).

<sup>42</sup> Neni 35 i KEDNJ-së i cili i referohet kriterëve për pranimin e aplikimeve para GJEDNJ-së, në paragrafin 2, (b) parashikon se GJEDNJ-ja nuk do të pranojë një aplikim individual të parashtruar në bazë të nenit 34 të KEDNJ-së kur pretendimet e ankesës janë në thelb të njëjta me pretendimet e ankesës të cilat GJEDNJ-ja i ka shqyrtuar më parë, nëse të njëjtat pretendime të ankesës tashmë janë dorëzuar në një organ tjetër hetimor ose gjyqësor ndërkombëtar dhe nëse ai aplikim nuk përmban fakte të reja.

<sup>43</sup> *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no.2) [GC], no. 32772/02, ECHR 2009

<sup>44</sup> *VgT Verein gegen Tierfabriken v. Switzerland*, no. 24699/94, ECHR 2001-VI

<sup>45</sup> *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2) [GC], no. 32772/02, § 67, ECHR 2009

Në mënyrë të ngjashme, në aktgjykimin e saj në rastin *Emre v. Switzerland* (no. 2)<sup>46</sup>, Gjykata konstatoi se aktgjykimi i ri vendor i marrë pas rihapjes së rastit, me të cilin gjykata vendore kreu një “balancim të ri të interesave”, përfaqëson një fakt të ri. Gjithashtu, në lidhje me këtë, u konstatua se ende nuk kishte filluar procedura për ekzekutim pranë Komitetit të Ministrave.

Nga ana tjetër, pretendime të ngjashme të ankesës u hodhën poshtë nga GJEDNJ-ja me vendimet e marra në rastet *Schelling v. Austria* (no. 2)<sup>47</sup> dhe *Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*<sup>48</sup>, sepse sipas vlerësimit të GJEDNJ-së, vendimet e gjykatave vendore me të cilat në këto raste u refuzuan kërkesat për përsëritjen e procedurave të kontestuara vendore, nuk bazoheshin ose nuk ishin të lidhura me shkaqe të reja relevante që mund të çonin në shkelje të re të KEDNJ-së.

Më tej, në *Steck-Risch and Others v. Liechtenstein*, GJEDNJ-ja konstatoi se Komiteti i Ministrave e mbylli mbikëqyrjen mbi ekzekutimin e aktgjykimit të mëparshëm të GJEDNJ-së para refuzimit të Gjykatës Kushtetuese për ta përsëritur procedurën dhe pa u mbështetur në faktin se mund të parashtrohet një kërkesë për përsëritjen e procedurës vendore pas aktgjykimit të GJEDNJ-së. Megjithatë, kjo kërkesë u shpall e papranueshme sepse nuk bëhej fjalë për ekzistimin e informacionit të ri relevant, gjegjësisht për ekzistencën e arsyeve të reja që mund të shkaktonin shkelje të re të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, veçanërisht duke pasur parasysh se refuzimi i referohej përsëritjes së procedurës për zhdëmtimin e dëmit për të cilin GJEDNJ-ja në aktgjykimin e saj inicial tashmë ka refuzuar shprehimisht të urdhërojë përsëritjen e procedurës. Në të njëjtën kohë, ajo theksoi se shtetet gëzojnë liri veprimi në mënyrën e ekzekutimit të aktgjyqimeve të saj dhe se vetëm në rrethana të jashtëzakonshme ajo urdhëron masa konkrete individuale për heqjen e shkeljes, kurse rrethana të tilla nuk ekzistonin në rastin në fjalë.<sup>49</sup>

Parimet e përgjithshme relevante në lidhje me pranimin e kërkesave të reja në lidhje me refuzimin e përsëritjes së një procedure të caktuar të kontestuar pas një aktgjykimi të Gjykatës janë përmbledhur në rastin e *Egmez v. Cyprus*<sup>50</sup>. Paragrafi 48 i këtij vendimi ri konfirmon se konstatimet e shkeljes në aktgjykimet e saj janë, në parim, deklarative (shih *Krčmár and Others v. the Czech Republic* (dec.), no. 69190/01, 30 March 2004; *Lyons and Others v. the United Kingdom* (dec.), no. 15227/03, ECHR 2003-IX; dhe *Marckx v. Belgium*, 13 June 1979, § 58, Series A no. 31). Për më tepër, në paragrafin 50, ritheksohet se GJEDNJ-ja nuk ka juridiksion për të verifikuar nëse palët kontraktuese i kanë përmbushur detyrimet e vendosura ndaj tyre nga aktgjykimet e Gjykatës dhe i ndalohej të shqyrtojë pretendimet e ankesës në lidhje me dështimin e shteteve për t'i zbatuar aktgjykimet, prandaj pretendimet

<sup>46</sup> *Emre v. Switzerland* (no. 2), no. 5056/10, 11 October 2011

<sup>47</sup> *Schelling v. Austria* (no. 2) (dec.), no. 46128/07, 16 September 2010

<sup>48</sup> *Steck-Risch and Others v. Liechtenstein* (dec.), no. 29061/08, 11 May 2010

<sup>49</sup> *Shih Steck-Risch and Others v. Liechtenstein* (dec.), no. 29061/08, §§ 72-73, 11 May 2010.

<sup>50</sup> *Egmez v. Cyprus* (dec.), no. 12214/07, §§ 48-56, 18 September 2012

e tilla të ankesës shpallen të papranueshme *ratione materiae*.<sup>51</sup>

Megjithatë, roli i Komitetit të Ministrave në këtë sferë nuk do të thotë se masat e marra nga shteti përgjegjës për korigjimin e shkeljes së konstatuar nga Gjykata nuk mund të nxisin një problem të ri që nuk zgjidhet me aktgjykimin dhe për rrjedhojë është lëndë për një aplikim të ri që mund të shqyrtohet nga Gjykata.<sup>52</sup>

Për këto arsye, në rastin *Egmez v. Cyprus*, Gjykata arriti në përfundimin se ishte kompetente të shqyrtonte aplikimet në seritë e mëposhtme të rasteve, si p.sh. kur autoritetet vendore kryejnë një hetim të ri në vend për rastin gjatë ekzekutimit të një prej aktgjyqimeve të Gjykatës, qoftë duke rifilluar procedurën (shih *Emre v. Switzerland* no. 2, no. 5056/10, 11 October 2011 dhe *Hertel v. Switzerland* (dec.), no. 53440/99, ECHR 2002-I), ose duke filluar një grup krejtësisht të ri të procedurave vendase (shih *The United Macedonian Organisation Ilinden – PIRIN and Others v. Bulgaria* (no. 2), nos. 41561/07 and 20972/08, 18 October 2011 dhe *Liu v. Russia* (no. 2), no.29157/09, 26 July 2011).<sup>53</sup>

Gjithashtu, kur ka shkelje të vazhdueshme të një të drejte nga Konventa pas miratimit të aktgjykimit, në të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje të kësaj të drejte në një periudhë të caktuar kohore, nuk është e pazakontë që Gjykata të shqyrtojë një aplikim të ri në lidhje me shkeljen e kësaj të drejte në periudhën pasuese (shih ndër të tjera, *Ivantoc and Others v. Moldova and Russia*, no. 23687/05, §§ 93-96, 15 November 2011 lidhur me parburgimin e vazhdueshëm; *Wasserman v. Russia* no. 2, no. 21071/05, §§ 36-37, 10 April 2008, sepse aktgjykimi vendor nuk ishte ekzekutuar). Në raste të tilla, “çështja e re” lind nga vazhdimi i shkeljes që ishte bazë e aktgjykimit fillestar të Gjykatës.<sup>54</sup>

### III.1.2. Praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së

Në lëndën *Bochan v. Ukraine* (no. 2)<sup>55</sup>, GJEDNJ-ja e shqyrtoi efektin e mosrespektimit të detyrimit për përsëritjen e procedurës gjyqësore që rezultoi nga shkelja e konstatuar në aktgjykimin e GJEDNJ-së në lidhje me garancitë nga neni 6 paragrafi 1 për gjykim të drejtë

<sup>51</sup> Si shembull, shihni vendimet e mëposhtme të GJEDNJ-së: *Moldovan and Others v. Moldova* (dec.), no. 8229/04 and other applications, 15 February 2011; *Dowsett v. the United Kingdom* (no. 2) (dec.), no.8559/08, 4 January 2011; *Ócalan v. Turkey* (dec.), no. 5980/07, 6 July 2010; *Haase v. Germany*, no.11057/02, ECHR 2004 III; *Komanický v. Slovakia* (dec.), no. 13677/03, 1 March 2005; *Lyons and Others v. the United Kingdom* (dec.), no. 15227/03, ECHR 2003IX; *Krčmár and Others v. the Czech Republic* (dec.), no. 69190/01, 30 March 2004; и *Franz Fischer v. Austria* (dec.), no. 27569/02, ECHR 2003VI.

<sup>52</sup> *Egmez v. Cyprus* (dec.), no. 12214/07, § 51, 18 September 2012. Në këtë kontekst, ajo u referohet lëndëve: *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2) [GC], no. 32772/02, § 62, ECHR 2009; *Hakkar v. France* (dec.), no.43580/04, 7 April 2009; *Haase v. Germany*, no. 11057/02, ECHR 2004III; *Mehemi v. France* (no. 2), no. 53470/99, § 43, ECHR 2003-IV; *Rongoni v. Italy*, no. 44531/98, § 13, 25 October 2001; *Rando v. Italy*, no. 38498/97, § 17, 15 February 2000; *Leterme v. France*, 29 April 1998, Reports 1998-III; *Pailot v. France*, 22 April 1998, § 57, Reports 1998-II; dhe *Olsson v. Sweden* (no. 2), 27 November 1992, Series A no. 250.

<sup>53</sup> *Egmez v. Cyprus* (dec.), no. 12214/07, § 52, 18 September 2012

<sup>54</sup> *Egmez v. Cyprus* (dec.), no. 12214/07, § 53, 18 September 2012

<sup>55</sup> *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, ECHR 2015

nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe për ofrimin e arsytimit të mjaftueshëm për vendimet.<sup>56</sup> Këto shkelje kishin të bëjnë me një proces gjyqësor afatgjatë në lidhje me pronësinë e tokës, të cilën aplikantja e ka humbur përpara gjykatave vendore.

Përveç faktit se Gjykata, me aktgjykimin e saj të datës 3 maj 2007, pas aplikimit të parë, i ka dhënë aplikantes 2.000 euro si zhdëmtim për dëmin jo material, në të njëjtën kohë e ka theksuar edhe mundësinë që aplikantja të parashtrijë një “ankesë në kontekstin e rrethanave të jashtëzakonshme”, gjë që ajo e ka bërë. Ajo i kërkoi Gjykatës Supreme të Ukrainës t’i anulojë vendimet e gjykatave më të ulëta në lidhje me rastin e saj dhe t’i miratojë kërkesat e saj në tërësi. Gjykata e Supreme e refuzoi ankesën e saj të jashtëzakonshme, pasi konstatoi se vendimet e gjykatave vendore ishin të drejta dhe të bazuara mirë.

Në një kërkesë të re në GJEDNJ, aplikantja u ankua se në refuzimin e ankesës së saj të jashtëzakonshme, Gjykata Supreme nuk i mori parasysh gjetjet e GJEDNJ-së në aktgjykimin e saj të datës 3 maj 2007. Duke pasur parasysh specifikën e pyetjeve të parashtruara nga aplikantja, kjo lëndë u kalua nga këshilli prej 7 gjyqtarësh, për shqyrtim dhe vendim të Këshilli i Madh Gjyqësor, i cili përfshin 17 gjyqtarë.<sup>57</sup>

Në rastin e mëpasshëm, Këshilli i Madh Gjyqësor konstatoi shkelje të nenit 6 paragrafi 1 në procedurën lidhur me ankesën e jashtëzakonshme duke pasur parasysh prezantimin e shtrembëruar të gjetjeve të aktgjykimit të GJEDNJ-së të dhënë nga Gjykata Supreme në vendimin e saj të datës 14 mars 2008, në kuadër të procedurës së kasacionit përpara saj, gjë që e ka e bërë të pamundur për aplikanten që kërkesa e saj e pronësisë të shqyrtohet në dritën e këtyre gjetjeve.

Aktgjykimi *Bochan v. Ukraine* (no. 2) paraqitet si një aktgjykim referues, të cilit Gjykata i është referuar në mënyrë të vazhdueshme në një sërë rastesh të ngjashme në të ardhmen, në të cilat shteti përgjegjës nuk i është përgjigjur pozitivisht kërkesave të aplikantëve për zbatimin e aktgjyqimeve të saj duke e përsëritur procedurën e caktuar të kontestuar të vendit.

Ajo është domethënëse nga disa aspekte:

Para së gjithash, në të GJEDNJ-ja i ri konfirmon pikëpamjet e veta që i ka marrë për herë të parë në rastin *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland* (no. 2), se autorizimi i Komitetit të Ministrave, në përputhje me nenin 46 paragrafi 2 të KEDNJ-së, për të mbikëqyruar ekzekutimin e aktgjyqimeve të Gjykatës, nuk e pengon Gjykatën ta shqyrtojë aplikimin e ri në lidhje me masat e marra nga shteti përgjegjës për ta ekzekutuar aktgjykimin, nëse ai aplikim përmban informacione të reja relevante në lidhje me çështjet për të cilat nuk është

<sup>56</sup> *Bochan v. Ukraine*, no. 7577/02, 3 May 2007

<sup>57</sup> Kjo është bërë në përputhje me mundësinë e parashikuar nga neni 30 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit “nëse lënda që është në shqyrtim para Këshillit ngre çështje serioze që ndikojnë në interpretimin e Konventës ose të Protokolleve të saj, ose nëse zgjidhja e ndonjë çështjeje nga ana e Këshillit mund të çojë në një rezultat që nuk është në përputhje me aktgjykimin e marrë më parë nga Gjykata, Këshilli ka mundësi që në çdo moment përpara se ta japë aktgjykimin e tij, t’ia delegojë juridiksionin Këshillit të Madh Gjyqësor, përveç rastit kur njëra nga palët e lëndës e kundërshton atë.”

vendosur në aktgjykimin fillestar.<sup>58</sup> Rrjedhimisht, Gjykata e konsideroi veten kompetente për të shqyrtuar çështjen e re të ngritur në kërkesën e dytë të parashtruar nga e njëjta aplikante, pa i cenuar prerogativat e shtetit përgjegjës - të Ukrainës dhe të KM-së nga neni 46 i KEDNJ-së, sepse vetë aplikimi vetëm në dukje iu referua mosekzekutimit, gjegjësisht mos efikasitetit të zbatimit të aktgjyqimit të GJEDNJ-së nga gjykatat nacionale, kurse ajo, në fakt, shumë më tepër ka qenë e lidhur me mënyrën e zhvillimit dhe drejtësinë e procedurës në të cilën ka vendosur Gjykata Supreme, sesa me vetë rezultatin përfundimtar të asaj procedure. Më konkretisht, si e rëndësishme në procedurën e re para GJEDNJ-së u paraqit pyetja nëse arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme ishte qartësisht në kundërshtim me gjetjet përkatëse të Gjykatës në aktgjykimin e saj të datës 3 maj 2007. Prandaj, aplikimi i dytë i referohej situatës që dallon nga ajo që është e shqyrtuar në aktgjykimin fillestar të GJEDNJ-së dhe përmbante informacione të reja relevante në lidhje me çështjet që nuk janë vendosur me atë aktgjykim.

Më tej, *Bochan v. Ukraine* (no. 2) ishte gjithashtu një mundësi e shkëlqyer për të sqaruar çështjen e zbatimit të nenit 6 në lidhje me kërkesat e jashtëzakonshme në proceset gjyqësore në lëndët civile. Në këtë kuptim, Gjykata konstatoi se neni 6 mund të zbatohet për sa i përket procedurës pas ankesës së jashtëzakonshme të aplikantes, edhe pse neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së zakonisht nuk zbatohet në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike për rihapjen e procedurave të përfunduara gjyqësore. Në fakt, duke u nisur nga natyra, diapazoni dhe karakteristikat e veçanta të ankesës së jashtëzakonshme për të cilën bëhet fjalë në rastin konkret, GJEDNJ-ja vlerësoi se sipas kornizës ligjore nacionale në fuqi, aplikantja kishte në dispozicion një mjet juridik që mundëonte shqyrtimin gjyqësor të lëndës së saj civile nga Gjykata Supreme në kontekstin e gjetjes së GJEDNJ-së se vendimet fillestare vendore nuk ishin në përputhje me Konventën. Rrjedhimisht, ajo procedurë mund të vendoset brenda diapazonit të nenit 6 paragrafi 1 dhe garancitë për gjykim të drejtë që ky nen ua ofron palëve në kontestin gjyqësor duhet të zbatohen në të njëjtën mënyrë siç zbatohen në procedurat e kasacionit në lëndët civile, në përgjithësi.<sup>59</sup>

Për sa i përket çështjes nëse janë respektuar garancitë e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së në procedurën pas ankesës së jashtëzakonshme, Gjykata theksoi se roli i saj nuk është të veprojë si shkallë e katërt dhe të shqyrtojë nëse aktgjyqimet e gjykatave nacionale janë në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, përveç nëse gjetjet e tyre mund të konsiderohen arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Ajo theksoi se në këtë rast, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj të datës 14 mars 2008, i ka paraqitur shumë gabim dhe në mënyrë arbitrare konstatimet e GJEDNJ-së në aktgjykimin e datës 3 maj 2007, duke bërë pretendime të rreme se vendimet e gjykatave vendore ishin të ligjshme dhe të bazuara, gjë që e ka penguar përpjekjen e aplikantes për ta shqyrtuar kërkesën e saj pronësore në dritën e aktgjyqimit fillestar të GJEDNJ-së dhe në kuadrin e një procedure të ngjashme me procedurën e kasacionit të parashikuar nga ligji vendor, që për pasojë kishte pengimin e drejtësisë, në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Si rezultat i shkeljes së konstatuar, kërkuases i është dhënë një shumë prej 10.000 eurosh si zhdëmtim për dëmin jo material.

<sup>58</sup> *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, § 33, ECHR 2015

<sup>59</sup> *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, §§ 50-56, ECHR 2015

Të njëjtat parime nga lënda *Bochan v. Ukraine* (no. 2), gjejnë zbatimin e tyre në shumë aktgjyqime të tjera që kanë të bëjnë me çështjen e mosrespektimit të detyrimit të shtetit për të respektuar aktgjyqimet e mëparshme të GJEDNJ-së, në të cilat është konstatuar shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së, e shprehur përmes refuzimit të përsëritjes së procedurës së kontestuar gjyqësore, e cila duhej të mundësonte anulimin e plotë të shkeljeve të konstatuara tashmë në aktgjykimin fillestar të GJEDNJ-së.

I tillë është rasti edhe me aktgjykimin e marrë pas kërkesës së dytë të parashtruar nga i njëjti kërkuar në lëndën *Yaremenko v. Ukraine* (no. 2)<sup>60</sup>. Në fakt, aktgjykimi i GJEDNJ-së i marrë me rastin e kërkesës së parë, i referohej procedurës penale kundër aplikantit në të cilën ai u dënua me burgim të përjetshëm, ku GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 3 të Konventës për shkak të dështimit në detyrimin e shtetit për të kryer një hetim efektiv për pretendimet se pranimi i fajit nga ana e tij është marrë pasi ai i është ekspozuar maltremit gjatë ndalimit policor pa praninë e avokatit. Përveç kësaj, u konstatua edhe shkelje e nenit 6, paragrafët 1 dhe 3 (c) të Konventës, duke qenë se dënimi i tij bazohej në atë pranim të fajit, megjithëse ai u tërhoq të nesërmen në prani të avokatit të tij dhe përveç kësaj, aplikantit iu mohua e drejta për ndihmë juridike sipas zgjedhjes së tij, sepse avokati i tij u hoq nga lënda nga ana e hetuesit gjatë procedurës, pasi e këshilloi të mbrohej në heshtje dhe të mos dëshmonte kundër vetes, gjë që e shkeli të drejtën e tij për të heshtur, si dhe privilegjin për të mos e inkriminuar veten. Në konstatimin përfundimtar për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, GJEDNJ-ja potencoi veçanërisht se mënyra e arsyetimit dhe mungesa e pretenduar e arsyeve për largimin e avokatit nga rasti, ngriti pyetje serioze lidhur me drejtësinë e procedurës në tërësi.

Duke vepruar në lidhje me aplikimin e dytë, GJEDNJ-ja u përqendrua në procedurën përpara Gjykatës Supreme të Ukrainës pas kërkesës së aplikantit për një shqyrtim të jashtëzakonshëm të lëndës së tij penale me theks në përputhjen e saj me garancitë për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës që lidheshin me të drejtën për të heshtur dhe ndalimin për inkriminimin e vetes. Në rastin konkret, aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishte një refuzim klasik i kërkesës për përsëritjen e procedurës, por ishte çështje e interpretimit të aktgjyqimit të GJEDNJ-së nga ana e Gjykatës Supreme, e cila në këtë kuadër dha një vlerësim shumë kritik ndaj pikëpamjeve të Gjykatës, të marra në aktgjykimin e saj, me ç' rast pranoi vetëm njëri nga vërejtjet e shumta për mënyrën e zhvillimit të procedurës penale të kontestuar, e pastaj duke i anashkaluar apo duke shprehur mospajtim me vërejtjet e tjera, i vërtetoi aktgjyqimet e shqiptuara në procedurën penale fillestare. Kështu, në kundërshtim me konstatimet e aktgjyqimit të parë të GJEDNJ-së për shkeljen e së drejtës për të heshtur dhe ndalimin e vetë-inkriminimit, Gjykata Supreme përjashtoi vetëm një pjesë të provave të marra në kundërshtim me Konventën, duke konstatuar se përjashtimi i tyre nuk do të ndikonte në rëndësinë vendimtare të provave të tjera të lëndës.

Për Gjykatën ishte e papranueshme që Gjykata Supreme bëri vetëm një rishqyrtim të kufizuar të lëndës, në vend që të lejonte rishqyrtimin e plotë të saj, që do të përfshinte edhe nxjerrje të plotë të provave. Duke vepruar kështu, aktgjykimi i kërkuarit edhe më tej bazohej në të

<sup>60</sup> *Yaremenko v. Ukraine* (no. 2), no. 66338/09, 30 April 2015

njëjtat prova akuzuese që u morën nëpërmjet shkeljes së të drejtave të tij procedurale.<sup>61</sup> Për rrjedhojë, në procedurën e përsëritur, Gjykata Supreme i përsëriti të njëjtat shkelje të së drejtës së kërkuesit për gjykim të drejtë, të drejtën për mbrojtje, të drejtën për të heshtur dhe privilegjin kundër vetë-akuzimit dhe është shkelur neni 6 paragrafi 1 dhe neni 6 paragrafi 3 (c) i Konventës.<sup>62</sup>

Duke vendosur për kërkesën për dëmshpërblim, GJEDNJ-ja theksoi se sa herë që një person dënohet në një procedurë të caktuar penale, e cila nuk i plotëson kushtet për drejtësi nga Konventa, rihapja, gjegjësisht fillimi i procedurës gjyqësore apo rishqyrtimi i lëndës, nëse kërkohet, duhet të jetë në përputhje me Konventën, si një mënyrë e përshtatshme për të korrigjuar shkeljen (shih, për shembull, *Leonid Lazarenko v. Ukraine*, no. 22313/04, § 65, 28 October 2010). Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja theksoi se përcaktimi i një shkeljeje të Konventës në vetvete nuk përbën zhdëmtim të drejtë në kuptim të nenit 41 të Konventës për dëmin jo material të pësuar nga aplikanti, për të cilin i dha atij një shumë prej 5.000 eurosh. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja iu referua edhe mundësisë për rigjykim, të parashikuar në legjislacionin ukrainas, e cila ishte në dispozicion të aplikantit, nëse ai e kërkon atë, duke theksuar se ai rigjykim do të duhej të ishte në përputhje me garancitë mbrojtëse materiale dhe procedurale të përfshira në nenin 6 të Konventës dhe do të duhej t'i marrë parasysh plotësisht konkluzionet e Gjykatës në rastin konkret dhe në aktgjykimin e GJEDNJ-së.<sup>63</sup>

Në mënyrë të ngjashme, në një lëndë tjetër penale, *Serrano Contreras v. Spain* (no. 2),<sup>64</sup> Gjykata e konstatoi pranimin e kërkesës së re, e cila në fakt i referohej procedurës penale kundër kërkuesit, në lidhje me të cilën, me një aktgjykim të mëparshëm të GJEDNJ-së, u konstatua shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë nga neni 6 për shkak të ndryshimit të aktgjykimit lirues në procedurën e ankimit në aktgjykim ndëshkues nga Gjykata Supreme spanjolle, pa mbajtur paraprakisht një seancë dëgjimore para tij. Pranimi i aplikimit të ri rezultoi nga refuzimi i pjesshëm i kërkesës së aplikantit për rishikimin e aktgjykimit në fjalë të Gjykatës Supreme (i cili, meqë ra fjala, u anulua vetëm në lidhje me njërin nga akuzat, ndërsa për dy akuzat e tjera mbeti në fuqi). Ky refuzim, sipas arsytimit të GJEDNJ-së, duhet të trajtohej si një “çështje e re” që i referohej një situatë të re, e cila përfshinte informacione krejtësisht të reja dhe nuk ishte marrë parasysh në procedurën pas kërkesës fillestare, në kundërshtim me argumentet e Qeverisë se me pranimin e kërkesës së re do të cenohej parimi *non bis in idem*.

GJEDNJ-ja fillimisht i përsëriti standardet e përgjithshme të vendosura në praktikën e mëparshme të saj në raste të ngjashme, gjegjësisht se konstatimi i shkeljes nga GJEDNJ-ja nuk jep të drejtën automatike për përsëritjen e procedurës dhe se shkelja e Konventës mund të korrigjohet edhe përmes përsëritjes së pjesshme të procedurës, nëse gjatë shqyrtimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik, gjykata vendase i paraqet arsyet për vendimin e saj të cilat i plotësojnë kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 (*Moreira Ferreira v. Portugal* no. 2 [GC], no. 19867/12, § 87, 11 July 2017). Gjithashtu, prezantimi i gjetjeve të mëparshme të Gjykatës

<sup>61</sup> *Yaremenko v. Ukraine* (no. 2), no. 66338/09, § 66, 30 April 2015

<sup>62</sup> *Yaremenko v. Ukraine* (no. 2), no. 66338/09, § 67, 30 April 2015

<sup>63</sup> *Yaremenko v. Ukraine* (no. 2), no. 66338/09, §§ 71-72, 30 April 2015

<sup>64</sup> *Serrano Contreras v. Spain* (no. 2), no. 2236/19, 26 October 2021

nuk duhet të jetë arbitrar në mënyrë që edhe sikur të paraqesë mohim të drejtësisë, që do të rezultonte në krijimin e një efekti të pengimit të përpjekjes së aplikantit, procedura kundër tij të shqyrtohej në dritën e aktgjykimit të Gjykatës në rastin e tij të mëparshëm (*mutatis mutandis*, *Bochan v. Ukraine* no. 2 [GC], no. 22251/08, § 64, ECHR 2015).<sup>65</sup>

Duke qenë se në aktgjykimin e saj fillestar, GJEDNJ-ja iu referua procedurës para Gjykatës Supreme spanjolle, të marrë në tërësi, pa bërë dallim nëse disa nga gjetjet e saj lidhen vetëm me disa prej dënimeve, interpretimi i Gjykatës Supreme në vendimin e saj për kërkesën për rishikim në lidhje me diapazonin dhe domethënien e konstatimeve të Gjykatës se shkelja e nenit 6 paragrafi 1 kishte të bënte vetëm me njërin nga akuzat, binte ndesh me gjetjet e GJEDNJ-së në aktgjykimin e saj fillestar. Duke vepruar kështu, Gjykata Supreme e kapërceu kufirin e vlerësimit të autoriteteve nacionale dhe i keqinterpretoi konkluzionet e përfshira në aktgjykimin e GJEDNJ-së, gjë që çoi në përfundimin se nuk ishin përmbushur kërkesat për gjykim të drejtë dhe u bë një shkelje tjetër e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës.<sup>66</sup>

Nga ana tjetër, qasja e Gjykatës ishte krejtësisht e ndryshme në lëndën *Moreira Ferreira v. Portugal* (no. 2), të përmendur më lart, e cila u ndërlidh me procedurën e zhvilluar pas aplikimit të parë të parashtruar nga e njëjta aplikante, në të cilën GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së për shkak të lëshimit që aplikantja të merrej në pyetje personalisht para Gjykatës së Apelit.<sup>67</sup> Për dallim nga *Bochan v. Ukraine* (no.2) dhe *Yaremenko v. Ukraine* (no. 2), në këtë rast, GJEDNJ-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6 për shkak të refuzimit të Gjykatës Supreme për të lejuar përsëritjen e procedurës penale, në të cilën aplikantja ishte dënuar. Gjykata Supreme vlerësoi se nuk kishte bazë për rishikimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, sepse ai nuk binte ndesh me aktgjykimin e GJEDNJ-s, ndërsa mos marrja në pyetje e aplikantes përfaqëonte një parregullsi procedurale që nuk i nënshtrohej rishikimit.

Në arsyetimin e saj, GJEDNJ-ja theksoi se Konventa nuk e garanton të drejtën e rihapjes së procedurës apo të llojeve të tjera të mjeteve juridike përmes të cilave mund të anulohet ose rishikohej vendimi përfundimtar i gjykatës. Në aktgjykimin e Këshillit Gjyqësor, të datës 5 korrik 2011, rigjykimi ose rihapja e procedurës me kërkesë të kërkuesit u cilësua si mjet adekuat, por jo i domosdoshëm, i vetëm ose ekskluziv për ekzekutimin e aktgjykimit të datës 5 korrik 2011 dhe për korrigjimin e shkeljes. Prandaj, Gjykata u përmbajt nga dhënia e udhëzimeve detyruese për atë se si të zbatohet aktgjykimi i saj dhe në vend të kësaj zgjodhi t'i jepte shtetit një hapësirë të gjerë manovrimi në atë sferë, duke ia lënë gjykatave vendase të vlerësojnë nëse do të ishte e përshtatshme të miratohej një rigjykim ose rihapje e procedurës, duke e marrë parasysh legjislacionin portugez dhe rrethanat specifike të lëndës.<sup>68</sup>

Në fakt, GJEDNJ-ja u mbështet në parimin e subsidiarititetit dhe në lirinë e vlerësimit vetanak që u është mundësuar autoriteteve vendase, duke i përfshirë edhe ato gjyqësore, gjatë interpretimit të aktgjyqimeve të Gjykatës. Gjegjësisht, për GJEDNJ-në mjaftoi që aktgjykimi

<sup>65</sup> *Serrano Contreras v. Spain* (no. 2), no. 2236/19, § 36, 26 October 2021

<sup>66</sup> *Serrano Contreras v. Spain* (no. 2), no. 2236/19, §§ 38-40, 26 October 2021.

<sup>67</sup> *Moreira Ferreira v. Portugal*, no. 19808/08, 5 July 2011

<sup>68</sup> *Moreira Ferreira v. Portugal* (no. 2) [GC], no. 19867/12, §§ 91-94, 11 July 2017



i Gjykatës Supreme nuk ishte arbitrar, gjegjësisht gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk e ndryshuan apo keqinterpretuan aktgjykimin që e ka marrë ajo. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të përfundonte se mënyra se si Gjykata Supreme e kishte lexuar aktgjykimin e saj ishte rezultat i një gabimi të qartë faktik ose ligjor që çoi në “pengimin e drejtësisë”.<sup>69</sup>

### III.2. Përsëritja e procedurës në bazë të vendimit të GJEDNJ-së

Në procedurat para GJEDNJ-së dhe në praktikën vendore, si e rëndësishme parashtrohet jo vetëm çështja e mundësisë së përsëritjes së procedurës gjyqësore vendore të kontestuar në bazë të aktgjykimit të GJEDNJ-së me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së, por edhe e mundësisë eventuale të përsëritjes së procedurave të kontestuara vendore në bazë të vendimeve (aktvendimeve) të KEDNJ-së me të cilat konstatohet se është arritur një ujdë miqësore ndërmjet shtetit, nga njëra anë dhe aplikantit, nga ana tjetër, si dhe mundësia e përsëritjes së procedurave në bazë të vendimeve të GJEDNJ-së të marra në bazë të një deklarate të njëanshme (deklarate unilaterale) si veprim i shtetit për njohjen e njëanshme të shkeljeve të KEDNJ-së.<sup>70</sup>

Në parim, vetëm në një numër të vogël shtetesh - palë kontraktuese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ekziston mundësia e rihapjes së procedurave gjyqësore vendore duke u bazuar në vendimin për ujdinë miqësore ose në bazë të deklaratës së njëanshme.<sup>71</sup> Kjo mundësi ose rrjedh drejtpërdrejt nga aktvendimet përkatëse legjislative ose, në raste më të rralla, rrjedh nga interpretimi i gjerë nga gjykatat vendore i dispozitave ligjore që e parashikojnë përsëritjen e proceseve gjyqësore vendore në bazë të aktgjykimit të GJEDNJ-së.<sup>72</sup> Në të gjitha vendet e tjera, përsëritja e procedurave rezervohet ekskluzivisht për rastet në të cilat shkelja e Konventës është konstatuar me aktgjykim të GJEDNJ-së.

Me këtë rast, shtetet më lehtë kanë bërë përsëritjen e procedurës pas vendimit të bazuar në një deklaratë të njëanshme, sesa pas vendimit me të cilin konstatohet ujdë miqësore e arritur midis palëve. Kjo është më se e kuptueshme duke pasur parasysh dallimin ndërmjet këtyre dy instrumenteve të ndarjes së drejtësisë të GJEDNJ-së. Do të thotë, fakti që shteti, si rregull, mund ta dorëzojë deklaratën e njëanshme në GJEDNJ, pasi të ketë dështuar përpjekja e mëparshme për të arritur një zgjidhje miqësore të çështjes për shkak të mungesës së pëlqimit nga ana e aplikantit, për dallim nga ujdë, e cila në vetvete nënkupton zgjidhjen përfundimtare të lëndës së Gjykatës, me çka i jepet fund statusit të aplikantit si viktimë e shkeljes së lirive dhe të drejtave të tij dhe për këtë arsye konsiderohet se ekziston një

pengesë ligjore për rihapjen e procedurës së kontestuar gjyqësore vendore.<sup>73</sup>

Në parim, vendimet e marra në bazë të një ujdë miqësore ndërmjet palëve në procedurën para GJEDNJ-së (Qeverisë dhe aplikantit) nuk mund dhe nuk duhet të përbëjnë bazë për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore, duke pasur parasysh tekstin e ujdës me të cilën, pothuajse pa përjashtim, palët heqin dorë nga çdo pretendim tjetër kundër shtetit në lidhje me faktet e lëndës në fjalë, në këmbim të të cilave shteti merr përsipër t'i paguajë kërkesit *ex gratia* një shumë të caktuar, si kompensim për dëmin e pësuar (jo material dhe/ose material) dhe/ose shpenzimet në procedurë. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që në disa raste, shteti, për qëllim të arritjes së ujdës, të marrë përsipër detyrime të veçanta dhe/ose shtesë, përveç pagesës *ex gratia* të një shume të caktuar monetare.<sup>74</sup>

Përndryshe, mund të përmenden shumë shembuj pozitivë të rihapjes së procedurave gjyqësore vendore pas dhënies së një deklarate të njëanshme me të cilën pranohet shkelja e Konventës. Kështu, rihapja e procedurës penale të kontestuar pas miratimit të vendimit të GJEDNJ-së në rastin *Taktakishvili v. Georgia*<sup>75</sup>, rezultoi me lirim të aplikantit, ndërsa deklarata e njëanshme në rastin *Sroka v. Poland*<sup>76</sup> çoi në anulimin e vendimeve vendore të miratuara më parë dhe ndalimin e procedurës penale, pasi në kuadër të procedurës së rifilluar u përfundua se vepra penale për të cilën akuzohej aplikanti nuk përbënte më inkriminim, sepse ndërkohë, dispozita ligjore përkatëse është shfuqizuar.<sup>77</sup>

<sup>69</sup> *Moreira Ferreira v. Portugal* (no. 2) [GC], no. 19867/12, §§ 96-97, 11 July 2017

<sup>70</sup> Termi “vendim”, në terminologjinë e KEDNJ-së, nënkupton një vendim procedural, pra një aktvendim me të cilin vendoset për pranueshmërinë e aplikimeve, për dallim nga aktgjykimin me të cilin vendoset në mënyrë meritore, për thelbin e një lënde të caktuar. Ky term përdoret edhe kur bëhet fjalë për vendime që i referohen një ujdë të arritur miqësore, gjegjësisht një deklarate të dhënë në mënyrë të njëanshme.

<sup>71</sup> Të tilla janë, për shembull: Republika Çeke, Gjeorgjia, Letonia, Moldavia, Polonia dhe Sllovenia.

<sup>72</sup> I tillë është rasti me Lituani dhe Republikën Çeke.

<sup>73</sup> GJEDNJ-ja i referohet parimeve të nenit 46 të KEDNJ-së kur vlerëson nëse në përputhje me nenin 37 paragrafi 1 (c) duhet të heqë një aplikim të caktuar nga lista e lëndëve në bazë të deklaratës së njëanshme të shtetit me të cilën ai i pranon pretendimet për shkelje të KEDNJ-së, duke iu referuar me këtë rast *acquis* së Komitetit të Ministrave. Neni 37 i KEDNJ-së parashikon që GJEDNJ-ja do të heqë një aplikim të caktuar nga lista e lëndëve nëse rrethanat lejojnë të arrihet në përfundimin a) se aplikanti e ka tërhequr aplikimin; b) se kontesti është zgjidhur ose c) se, për çfarëdo arsye tjetër, ekzistencën e së cilës e përcaktohen Gjykata, nuk justifikohet më vazhdimi i shqyrtimit të aplikimit, Megjithatë, Gjykata vazhdon të shqyrtojë kërkesën nëse këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara me Konventën dhe Protokollet e saj. 2. Gjykata mund të vendosë ta kthejë aplikimin në listën e lëndëve nëse çmon se rrethanat e justifikojnë këtë. Kështu, për shembull, në disa lëndë GJEDNJ-ja e ka hequr kërkesën nga lista e lëndëve, pasi ka shprehur kënaqësinë se respektimi i të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe Protokollet e saj, nuk kërkonte që ajo të vazhdonte me shqyrtimin e aplikimit, veçanërisht duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të qartë dhe të gjerë për çështjen e ngritur në aplikim. Në veçanti, GJEDNJ-ja konsideroi se natyra dhe shtrirja e detyrimeve që lindin nga KEDNJ-ja për shtetin e mbajtur përgjegjës, tashmë ishte elaboruar mjaftueshëm në shumë aktgjykime të saj. Për më tepër, edhe çështjet e diskutueshme iu prezantuan mjaftueshëm Komitetit të Ministrave dhe ishin nën mbikëqyrje në përputhje me kushtet e nenit 46 paragrafi 2 të Konventës (*Tasdemir v. Turkey* (dec.), 2019, § 22).

<sup>74</sup> Tani për tani, i vetmi rast në nivel kombëtar i ujdës së arritur miqësore për qëllimet, për të cilat shteti ka marrë një detyrim të veçantë, është rasti *Trifunovski*, nr. 24094/11, vendimi i datës 2 qershor 2015. Duke pasur parasysh se Komiteti i Ministrave e mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve të marra në bazë të ujdës miqësore edhe atë vetëm në pjesën e detyrimeve që i ka marrë përsipër qeveria, gjegjësisht shteti, për qëllimet e ujdës, teksti i ujdës së arritur të cilës i referohet vendimi i GJEDNJ-së është vendimtar, si për sa i përket detyrimeve të marra përsipër nga shteti, ashtu edhe për sa i përket diapazonit të mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e vendimit në bazë të ujdës që e zbaton Komiteti i Ministrave.

<sup>75</sup> *Taktakishvili v. Georgia* (dec.), no. 46055/06, 16 October 2012

<sup>76</sup> *Sroka v. Poland* (dec.), no. 42801/07, 6 March 2012

<sup>77</sup> Strasbourg, 12 February 2016, DH-GDR (2015)008 Rev, STEERING COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS (CDDH), COMMITTEE OF EXPERTS ON THE REFORM OF THE COURT (DH-GDR), Overview of the exchange of views held at the 8th meeting of DH-GDR on the provision in the domestic legal order for the re-examination or reopening of cases following judgments of the Court (prepared by the Secretariat), gjendet në <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090001680654d5a>, fq. 12, paragrafi 33.

Lënda *Jerovičs v. Latvia*<sup>78</sup> rezultoi nga dështimi i shtetit përgjegjës për të përmbushur detyrimet e tij të marra përsipër me deklaratën e njëanshme të dhënë nga ana e tij në një lëndë të mëparshme të iniciuar nga i njëjti aplikant, me të cilën është pranuar shkelja e nenit 3 të KEDNJ-së (ndalimi i torturës). Kjo shkelje ishte si rezultat i trajtimit të cilit iu nënshtua aplikanti nga personat zyrtarë të policisë përderisa ishte i ndaluar në stacionin policor dhe i mënyrës se si u krye hetimi në lidhje me këtë.<sup>79</sup> Përveç kësaj, ka pasur edhe shkelje të nenit 5 paragrafi 5, nenit 6 paragrafi 1, nenit 13 dhe nenit 14 të KEDNJ-së për shkak të mënyrës së veprimit në lidhje me kërkesat për dëmshpërblim të aplikantit dhe kohëzgjatjes së procedurës penale kundër tij, e veçanërisht për shkak të refuzimit të kërkesave të tij për ndihmë juridike për të pasur qasje në një procedurë në të cilën ai do të dëmshpërblehej. Krahas pranimit të shkeljeve të shumta të Konventës, shteti, me deklaratën e njëanshme, mori përsipër t'i paguante aplikantit një dëmshpërblim në vlerë prej 4.500 eurosh, si dhe t'i merrte të gjitha masat që ishin të nevojshme për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen.<sup>80</sup>

Në fakt, kërkesa e re është dorëzuar nga i njëjti aplikant, pasi prokurori publik kompetent e ka refuzuar kërkesën e tij për përsëritjen e procedurës penale të kontestuar në të cilën ai është akuzuar, si dhe procedurën lidhur me sjelljen e pretenduar joadekuate të personave zyrtarë të policisë. Kjo kërkesë u refuzua edhe pse bazohej në kushtet e deklaratës së njëanshme të dorëzuar nga qeveria, të cilën prokurori nuk e konsideroi si një rrethanë të re të zbuluar, ndërsa dispozitat përkatëse të Ligjit të Procedurës Penale të Letonisë lejonin përsëritjen e procedurës së përfunduar penale në bazë të rrethanave të reja të zbuluara, si dhe në bazë të konstatimeve të një organi gjyqësor ndërkombëtar se një aktgjykim apo vendim i caktuar i marrë nga institucionet gjyqësore të Letonisë nuk ka qenë në përputhje me rregullat ndërkombëtare që janë të detyrueshme për shtetin.

Duke e shqyrtuar aplikimin e ri, Këshilli i Madh Gjyqësor të cilit i është dorëzuar lënda nga këshilli, si një formacion më i ulët gjyqësor i GJEDNJ-së, kujtoi se edhe në rast se GJEDNJ-ja do ta pranonte deklaratën e njëanshme dhe në përputhje me këtë, do të vendosë ta tërheqë kërkesën nga lista e lëndëve, ky pranim është i kushtëzuar dhe varet nga plotësimi i kushteve të përcaktuara në deklaratë, ndërsa GJEDNJ-ja e rezervon të drejtën që të njëjtën kërkesë (ose një pjesë të saj) ta kthejë në listën e saj të lëndëve. Në këtë kuptim, Gjykata kryen një shqyrtim të plotë të vëllimit dhe diapazonit të detyrimeve të ndryshme të ndërmarrë nga shteti nëpërmjet deklaratës së Qeverisë, siç janë deklaruar në vetë vendimin e GJEDNJ-së me të cilin kërkesa fshihet nga lista e lëndëve dhe në të njëjtën kohë, ka mundësinë të kontrollojë dhe të verifikojë nëse qeveria ka vepruar në përputhje me ato detyrime të marra<sup>81</sup>, për të vendosur përfundimisht nëse ka “rrethana të jashtëzakonshme” që e justifikojnë

<sup>78</sup> *Jerovičs v. Latvia* [GC], no. 44898/10, 5 July 2016

<sup>79</sup> Megjithëse, siç theksohet në Parathënie, ky publikim nuk merret me përsëritjen apo vazhdimin e hetimeve të kontestuara apo me fillimin e hetimeve të reja pas një aktgjykimi të GJEDNJ-së në të cilin është konstatuar shkelje e aspekteve procedurale të të drejtave nga Konventa, lënda *Jerovičs v. Latvia* përfshihet dhe analizohet ekskluzivisht nga këndvështrimi i pranueshmërisë së kërkesës për përsëritjen e procedurës vendore, pasi të jepet deklarata e njëanshme.

<sup>80</sup> *Jerovičs v. Latvia* (dec.), no. 547/02, 10 February 2009

<sup>81</sup> *Jerovičs v. Latvia* [GC], no. 44898/10, §§ 67-68, 5 July 2016

kthimin e aplikimit në listën e lëndëve.<sup>82</sup>

Edhe pse në vendimin e saj për heqjen e aplikimit nga lista e lëndëve, Gjykata nuk i potencoi në mënyrë eksplicite Qeverisë se asaj i mbetej detyrimi për të kryer një hetim efektiv, Gjykata vlerësoi se sipas vendimit për deklaratën e njëanshme, kërkuesi e ruajti mundësinë për të përdorur “çdo mjet juridik që kishte në dispozicion me qëllim të eliminimit të shkeljes”, si supozim për heqjen e aplikimit nga lista e lëndëve nga Gjykata. Kjo nënkuptonte se shteti kishte një detyrim të vazhdueshëm procedural për t'i ofruar kërkuesit një formë të caktuar të procedurës për hetimin e trajtimit joadekuate që iu bë nga personat zyrtarë të shtetit. Një detyrim i tillë nuk u zhduk me pranimin e shkeljeve dhe pagesën e dëmshpërblimit nga shteti përgjegjës, sepse procedura pas deklaratës së njëanshme nuk kishte për qëllim t'i lejonte shtetit të shmangte përgjegjësinë e tij për shkeljet e të drejtave themelore që i përmban Konventa. Edhe pse Konventa, në parim, nuk e garanton të drejtën për të përsëritur procedurën vendore, GJEDNJ-ja megjithatë ishte në gjendje të shqyrtonte nëse mënyra në të cilën autoritetet letone vepruan në lidhje me kërkesën për përsëritjen e procedurës prodhoi efekte që ishin të papajtueshme me detyrimin e tyre të vazhdueshëm për të zbatuar një hetim efektiv, i cili në këtë rast nuk u respektua dhe që për pasojë kishte ri konstatimin e shkeljes së nenit 3 në aspektin procedural.<sup>83</sup>

<sup>82</sup> Në fakt, specifika e vendimeve për deklaratën e njëanshme shihet pikërisht në faktin se mbikëqyrja e zbatimit të tyre në drejtim të respektimit të detyrimeve të marra nga shteti përgjegjës, të përcaktuara në vetë deklaratën, kryhet nga GJEDNJ-ja, për dallim nga vendimet për ujdinë miqësore dhe natyrisht nga aktgjykimet, ekzekutimi i të cilave mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave.

<sup>83</sup> *Jerovičs v. Latvia* [GC], no. 44898/10, §§ 110-124, 5 July 2016

## IV. Përsëritja e procedurës si masë individuale për ekzekutimin e aktgjyimeve dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lëndët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut

### IV.1. Korniza ligjore

GJEDNJ-ja ka marrë qëndrimin se është detyrë e shteteve të vendosin se si do t'i zbatojnë më mirë aktgjykimet e tyre. Edhe atëherë kur parashikojnë mundësinë për të kërkuar rihapjen e procedurës së përfunduar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës, autoritetet vendore duhet të parashikojnë një procedurë në të cilën këto kërkesa do të shqyrtohen dhe do të përcaktojnë kritere për të vendosur nëse përsëritja e kërkuar është e nevojshme në një rast të caktuar. Parimisht, nuk ekziston një qasje uniforme midis shteteve lidhur me mundësinë e kërkesës për rihapjen e procedurave të përfunduara gjyqësore pas konstatimit të shkeljes nga Gjykata ose në lidhje me modalitetet për zbatimin e mekanizmave ekzistues për rihapjen e procedurave.<sup>84</sup>

Vënia në dispozicion e procedurave që lejojnë rishqyrtimin e lëndës kur konstatohet shkelje e nenit 6 e tregon përkushtimin e shtetit anëtar ndaj Konventës, si dhe ndaj praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe është mënyra më e mirë për të arritur kthimin në gjendjen fillestare të kërkuarit (*restitutio in integrum*).<sup>85</sup>

Në drejtim të zbatimit efikas të Rekomandimit nr. R (2000) 2, Këshilli i Evropës u kërkoi shteteve të tij anëtare të siguronin mundësinë e rihapjes së procedurave penale dhe i inkurajoi ato të konsideronin futjen e një mundësie të tillë në procedurat civile dhe administrative.<sup>86</sup>

Mundësia e përsëritjes së procedurave gjyqësore pas një aktgjykimi të GJEDNJ-së, me të cilin konstatohet shkelje e Konventës, sigurohet ose nëpërmjet legjislationit përkatës (procedural), i cili në mënyrë të hollësishme e parashikon bazën ligjore për këtë, ose nënkuptohet, nëpërmjet interpretimit të formulimeve të përgjithshme ligjore në drejtim të lejimit të rigjykitimit.

Ligjvënisi i Maqedonisë së Veriut zgjodhi opsionin e parë. Përkatësisht, përveç dispozitave ligjore që e rregullojnë përsëritjen e procedurave si mjet i jashtëzakonshëm juridik në

<sup>84</sup> *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, § 57, ECHR 2015

<sup>85</sup> *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, § 58, ECHR 2015

<sup>86</sup> Review of the implementation of Recommendation (2000) 2 of the Committee of Ministers to the Member States on re-examination and reopening of certain cases at domestic level following judgments of the European Court of Human Rights, paragrafi 22, gjendet në <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168066b42a>

kuptimin e përgjithshëm, në të tri ligjet procedurale: Ligjin për Procedurën Kontestimore, Ligjin për Procedurën Penale dhe Ligjin për Kontestet Administrative, ekzistenca e një aktgjykimi të GJEDNJ-së, me të cilin është vërtetuar shkelje e KEDNJ-së, parashihet si bazë e veçantë juridike për përsëritjen e procedurës së kontestuar gjyqësore vendase.<sup>87</sup>

Përsëritja e procedurave gjyqësore pas shkeljes së konstatuar të KEDNJ-së, **nuk është automatike** përkundrazi, në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, ajo i nënshtrohet plotësimi të kriterëve specifike për pranimin e kërkesës, gjegjësisht propozimit për përsëritje (të cilat parashikohen nga legjislationi përkatës nacional ose zhvillohen nga vetë praktika gjyqësore vendore, si supozim për të lejuar përsëritjen). Përmbushja e tyre mbikëqyret nga gjykatat vendore, të cilat kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë sferë (*Moreira Ferreira v. Portugal* no. 2 [GC], no. 19867/12, § 53, 11 July 2017).

Me këtë rast, midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, ekzistojnë zgjidhje krejtësisht të ndryshme legjislative në lidhje me:

- subjektet e autorizuara për të parashtruar kërkesën, përkatësisht propozimin për përsëritjen e procedurës gjyqësore pas aktgjykimit të GJEDNJ-së;
- gjykatën, përkatësisht organin të cilit i parashtrohet kërkesa, gjegjësisht propozimi për përsëritje<sup>88</sup>;
- gjykata, gjegjësisht organi kompetent për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën, gjegjësisht propozimin për përsëritje.<sup>89</sup>;
- afatet në të cilat mund të parashtrohet kërkesa, gjegjësisht propozimi për përsëritje etj.

Nga ana tjetër, disa vende nuk kanë legjislation të posaçëm që do ta trajtonte çështjen e përsëritjes së procedurave gjyqësore pas aktgjykimit të GJEDNJ-së, kështu që zbatohen

<sup>87</sup> Në këtë kontekst edhe pse del përtej diapazonit të këtij materiali, është e nevojshme të theksohet se mungon vetëm një mjet juridik që do të lejonte përsëritjen e procedurës së zhvilluar para Gjykatës Kushtetuese në bazë të kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, nëse me aktgjykim të GJEDNJ-së është vërtetuar se me atë procedurë është shkelur Konventa. Këtu duhet përmendur se, e nxitur nga nevoja për përsëritjen e procedurës pas ankimit kushtetues në rastet për të cilat është konstatuar shkelje nga GJEDNJ-ja, Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës, në maj të vitit 2014, e ka ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren e saj të punës për të parashikuar një mundësi të tillë për përsëritjen e procedurës në rastet në të cilat është konstatuar shkelje e së drejtës për qasje në Gjykatën Kushtetuese.

<sup>88</sup> Kështu, për shembull, në disa vende, përsëritja e procedurave penale mund të fillohet edhe nga vetë autoritetet shtetërore, si për shembull Prokuroria publike në: Austri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Estoni, Finlandë dhe Moldavi.

<sup>89</sup> Në një numër të madh vendesh, Gjykata Supreme është kompetente për të vendosur a pranohet kërkesa, përkatësisht propozimit për përsëritjen e procedurës, veçanërisht në lëndët penale (Shqipëri, Austri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Qipro dhe Holandë). Në disa vende, një kompetencë e tillë i njihet Gjykatës Supreme, si në lëndët penale ashtu edhe në ato civile (Estoni dhe Lituani), ndërsa në disa të tjera, për përsëritjen e procedurave civile vendos gjykata e shkallës së parë para se cilës është zhvilluar procedura (Bosnjë dhe Hercegovinë) ose fare nuk parashikohet mundësia e përsëritjes së tyre në përputhje me parimin e *res judicata* (Greqi dhe Slloveni). Për përsëritjen e procedurave gjyqësore-administrative, ndonjëherë ka kompetencë eksplicite të Gjykatës së Lartë Administrative (për shembull, në Lituani), ndërsa në Norvegji, kërkesa për përsëritjen e procedurës penale pas aktgjykimit të GJEDNJ-së, parashtrohet në një organ të posaçëm, i quajtur Komisioni për rishqyrtimin e lëndëve penale.

rregullat e përgjithshme që e rregullojnë procedurën përkatëse.<sup>90</sup>

Në vazhdim janë paraqitur zgjidhjet aktuale në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Ligji për Procedurën Kontestimore** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015)

**Neni 400**

**Përsëritja e procedurës me rastin e aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg**

(1) Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstaton cenimin e një të drejte të njeriut ose të lirive themelore të parashikuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe në Protokollet Shtesë të Konventës, të cilat Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar, pala mundet në afat prej 30 ditësh nga aktgjykimi definitiv i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut t’i parashtrijë kërkesë gjykatës në Republikën e Maqedonisë që ka gjykuar në shkallë të parë në procedurën në të cilën është marrë vendimi me të cilin është cenuar ndonjë e drejtë ose liri themelore e njeriut për ndryshimin e vendimit me të cilin është cenuar ajo e drejtë ose liri themelore.

(2) Në procedurën nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat për përsëritjen e procedurës.

(3) Në përsëritjen e procedurës, gjykatat janë të obliguara t’i respektojnë qëndrimet juridike të shprehura në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të cilin është konstatuar cenimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

**Ligji për Procedurën Penale** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 150/2010, 100/2012, 142/2016 dhe 198/2018)

**Neni 449**

**Përsëritja e procedurës në favor të të dënuarit**

(1) Procedura penale e përfunduar me aktgjykim përfundimtar mund të përsëritet në favor të të dënuarit, nëse:

- 1)...
- 2)...

6) me vendim të plotfuqishëm të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjatë procedurës konstatohet cenim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

<sup>90</sup> Një pasqyrë e detajuar krahasuese e legjislacionit në sisteme të ndryshme ligjore kombëtare mund të gjendet në: STEERING COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS (CDDH)-COMMITTEE OF EXPERTS ON THE REFORM OF THE COURT (DH-GDR), Compilation of written contributions on the provision in the domestic legal order for re-examination or reopening of cases following judgments of the Court / Compilation of contributions écrites sur les possibilités dans l’ordre juridique interne pour le réexamen ou la réouverture d’affaires à la suite d’arrêts de la Cour, DH-GDR(2015)002REV, Strasbourg, 31 March/mars 2016, gjendet në <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680654d4f>

**Ligji për Kontestet Administrative** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 96/2019)<sup>91</sup>

**Neni 82**

**Procedura e cila me vendim të gjykatës ka përfunduar në mënyrë të plotfuqishme, mund të përsëritet me kërkesë të palës nëse:**

- 1)...
- 2) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar shkelje të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me aktgjykim përfundimtar ose ka marrë vendim në bazë të deklaratës së njëanshme të shtetit për pranimin e shkeljes së Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- 3)...

(4) Propozimi për përsëritjen e procedurës parashtrijë në afat prej 30 ditësh nga dita kur pala ka mësuar arsyen e përsëritjes, gjegjësisht në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është bërë i plotfuqishëm, gjegjësisht nga dita e miratimit të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përsëritja nuk mund të propozohet sipas bazave të paragrafit (1) pikat 1 dhe 5 të këtij neni pas kalimit të një viti nga data kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm.

Në fund, **Ligji për Procedurën Jashtëkontestimore** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 09/2008) në nenin 33, paragrafi 1, përmban një dispozitë referuese që i referohet zbatimit të përshtatshëm të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, nëse Ligji për Procedurën Jashtëkontestimore nuk parasheh ndryshe. Duke pasur parasysh dispozitën e këtillë referuese, si dhe faktin se Ligji për Procedurën Jashtëkontestimore nuk e rregullon çështjen e përsëritjes së procedurës pas aktgjykimit të GJEDNJ-së, në këtë rast, zbatim gjejnë dispozitat përkatëse të nenit 400 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Siç shihet nga zgjidhjet e mësipërme ligjore, ndryshe nga disa sisteme juridike ku përsëritja e procedurës mund të iniciohet edhe nga subjekte të tjera përveç vetë kërkuarit, në Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe në Ligjin për Kontestet Administrative është lënë që të rrjedh nga aplikanti, i cili me aktgjykimin e GJEDNJ-së është identifikuar si viktimë e njërës prej lirive dhe të drejtave të Konventës. Për dallim nga kjo, Ligji për Procedurën Penale nuk përmend shprehimisht që kërkesën, gjegjësisht propozimin për përsëritjen e procedurës penale duhet ta parashtrijë personi i dënuar, i cili është paraqitur në cilësinë e kërkuarit

<sup>91</sup> Me Ligjin e ri për Kontestet Administrative, është bërë një rregullim plotësues domethënës i kësaj çështjeje në krahasim me zgjidhjen e mëparshme që gjendet në nenin 43 të Ligjit për Kontestet Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/2006). Në të, vetëm shkurtimisht, thuhet: “procedura e përfunduar me aktgjykim ose me aktvendim do të përsëritet me kërkesë të palës: ... 7) me vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.” Për sa i përket afatit në të cilin mund të kërkohet përsëritja e procedurës, ka qenë në fuqi dispozita e përgjithshme e nenit 44 sipas së cilës: “përsëritja e procedurës mund të kërkohet jo më vonë se brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka mësuar arsyen e përsëritjes. Nëse pala ka mësuar për arsyen e përsëritjes para përfundimit të procedurës në gjykatë, por nuk ka mundur ta përdorë atë arsye gjatë procedurës, përsëritja mund të kërkohet në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit. Pas kalimit të pesë viteve nga momenti kur vendimi është bërë i plotfuqishëm, nuk mund të kërkohet përsëritje”.

para Gjykatës, ndonëse praktika e deritanishme gjyqësore vendore vazhdon në atë drejtim.

Kur bëhet fjalë për dilemën nëse vendimi i GJEDNJ-së me të cilin konstatohet deklarata e njëanshme e shtetit për pranimin e shkeljes së KEDNJ-së në formën e një deklarate të njëanshme do të mund të shfaqej si bazë për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore, duhet theksuar se dilema e këtillë nuk ekziston më për sa i përket kontesteve administrative, pasi që Ligji për Kontestet Administrative i vitit 2019 në nenin 87, paragrafi 1, pikat (1) dhe (2) parashikoi mundësinë që *procedura që është përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës, me propozim të palës të përsëritet, nëse GJEDNJ-ja me aktgjykim të plotfuqishëm ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së ose ka marrë vendim në bazë të deklaratës së njëanshme të shtetit për njohjen e shkeljes së KEDNJ-së.*

Ndryshe nga Ligji për Kontestet Administrative, as Ligji për Procedurën Kontestimoree as Ligji për Procedurën Penale nuk përmbajnë dispozita të ngjashme, gjë që paraqet një lloj zbrazëtire ligjore që mund të plotësohet nga praktika gjyqësore vendore.

Për sa i përket afateve në të cilat mund të kërkohet përsëritja e procedurave, duhet theksuar se në nivel të shteteve anëtare, Këshilli i Evropës përfundoi se ato afate duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e procedurave edhe para vetë GJEDNJ-së, si dhe që ato të përcaktohen qartë. Mund të ketë dy lloje afatesh, edhe atë: afatet e llogaritura nga data e miratimit të aktgjykimit të GJEDNJ-së ose afatet e llogaritura nga data e miratimit të vendimit të fundit të gjykatës më të lartë vendore me të cilin shteren mjetet juridike efektive në nivel nacional, ose mund të bëhet fjalë për një zbatim të kombinuar të dy llojeve të afateve, në varësi të zgjidhjeve ligjore të miratuara në sistemet e ndryshme ligjore kombëtare.<sup>92</sup>

Në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut, afatet e tilla janë të përcaktuara në Ligjin për Procedurën Kontestimoree dhe në Ligjin për Kontestet Administrative, ndërsa në Ligjin për Procedurën Penale mungon afati i caktuar kohor për parashtrimin e propozimit për përsëritjen e procedurës penale të kontestuar për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të Konventës. Në të njëjtën kohë, rrjedhja e këtyre afateve është e lidhur me aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në Ligjin për Procedurën Kontestimoree) ose me ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjegjësisht miratimit të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në Ligjin për Kontestet Administrative).<sup>93</sup>

Për sa i përket afateve në të cilat mund të kërkohet përsëritja e procedurës vendore që ka qenë lëndë shqyrtimi në GJEDNJ dhe ka përfunduar me marrjen e vendimit për deklaratë

<sup>92</sup> Strasbourg, 12 February 2016, DH-GDR (2015)008 Rev, STEERING COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS (CDDH), COMMITTEE OF EXPERTS ON THE REFORM OF THE COURT (DH-GDR), Overview of the exchange of views held at the 8th meeting of DH-GDR on the provision in the domestic legal order for the re-examination or reopening of cases following judgments of the Court (prepared by the Secretariat), gjendet në <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680654d5a>, fq. 5, paragrafi 10 c)

<sup>93</sup> Në këtë kontekst, pavarësisht terminologjisë së ndryshme, termat aktgjykim përfundimtar dhe plotfuqishmëri janë sinonime.

të njëanshme, sipas nenit 87 paragrafi 1 pika (4) të Ligjit për Kontestet Administrative *propozimi për përsëritjen e procedurës parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga dita kur pala ka mësuar për arsyen e përsëritjes, gjegjësisht në afat prej 90 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.* Prandaj, si afati subjektiv (i cili lidhet me mësimin e arsyes së përsëritjes) ashtu dhe ai objektiv (që fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së vendimit të GJEDNJ-së) është identik me afatet e përcaktuara në rastet kur shkelja konstatohet me aktgjykim, me atë ndryshim që, në atë rast, afati objektiv llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të GJEDNJ-së.

Duhet pasur parasysh se zgjidhjet e këtilla ligjore për sa i përket afateve burojnë nga rregullat e përgjithshme të plotfuqishmërisë së aktgjyimeve, gjegjësisht nga vendimet e marra nga GJEDNJ-ja. Në fakt, aktgjykimet e GJEDNJ-së me të cilat konstatohet shkelje e KEDNJ-së mund të miratohen nga një Komitet prej tre gjyqtarësh, një Këshill prej shtatë gjyqtarësh dhe nga Këshilli i Madh Gjyqësor prej 17 gjyqtarësh.<sup>94</sup> Aktgjykimet e marra nga Komiteti prej tre gjyqtarësh bëhen të plotfuqishme në ditën e sjelljes së tyre, sikurse edhe aktgjykimet e Këshillit të Madh Gjyqësor, ndërsa aktgjykimet e marra nga Këshilli prej shtatë gjyqtarësh bëhen të plotfuqishme pas skadimit të afatit prej 3 (tre) muajsh pas miratimit të tyre, të paraparë për parashtrimin e kërkesës për referimin e lëndës në Këshillin e Madh Gjyqësor në nenin 43 paragrafi 1 të KEDNJ-së.<sup>95</sup> Aktgjykimet e GJEDNJ-së publikohen në ueb-faqen e saj në bazën e të dhënave HUDOC të Këshillit të Evropës, kështu që, në parim, konsiderohen se u janë dorëzuar palëve në kontest, duke pasur parasysh se GJEDNJ-ja nuk ka detyrim për dorëzim të rregullt, në mënyrë analoge me detyrimin e parashkuar për dorëzim të rregullt në legjislacionin vendor.

Nga ana tjetër, vendimet e GJEDNJ-së të marra në bazë të ujdisë, si dhe vendimet e marra në bazë të deklaratës së njëanshme të shtetit me të cilën pranohet shkelja e KEDNJ-së, bëhen të plotfuqishme në ditën e publikimit të tyre. Sidoqoftë, nuk duhet harruar ajo që u përmend më parë. Gjegjësisht, në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të marra nga shteti me deklaratën e njëanshme me të cilën pranohet shkelja e KEDNJ-së, e të cilave i referohet vendimi i GJEDNJ-së, ekziston mundësia që GJEDNJ-ja më vonë ta kthejë në listën e lëndëve gjyqësore lëndën të cilën me vendimin e tillë e kishte hequr më parë nga lista e saj e lëndëve.

## IV.2. Praktika relevante gjyqësore vendore

Siç u theksua më lart, GJEDNJ-ja nuk ka kompetencë eksplicite për të urdhëruar përsëritjen e procedurës vendore të kontestuar, në lidhje me të cilën është konstatuar shkelje e KEDNJ-së. Megjithatë, për shembull, kur një individ dënohet si fajtor në një procedurë që, në

<sup>94</sup> Këto formacione gjyqësore janë të rregulluara në nenin 26 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>95</sup> Në përputhje me nenin 44 të KEDNJ-së, aktgjykimi i Këshillit të Madh Gjyqësor është përfundimtar, gjegjësisht i plotfuqishëm, e i tillë bëhet edhe aktgjykimi i Këshillit kur: a) palët do të deklarojnë se nuk do të kërkojnë që lënda të dërgohet në Këshillin e Madh Gjyqësor; b) tre muaj nga data e marrjes së aktgjykimit, nëse nuk është kërkuar që lënda të dërgohet në Këshillin e Madh Gjyqësor ose c) nëse Këshilli i Madh Gjyqësor e refuzon kërkesën e parashtruar në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KEDNJ-së.

kundërshtim me KEDNJ-në, nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 6, për shkak të së cilës KEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja mund të bëjë me dije se nëse aplikanti kërkon, përsëritja e procedurës përbën, në parim, mënyrë adekuate për korrigjimin e shkeljes. Kjo qasje është shumë e pranishme edhe kur bëhet fjalë për aktgjykimet e GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut.

Aktgjykimet e para kundër shtetit në të cilat GJEDNJ-ja iu referua shprehimisht mundësisë për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore, në kontekstin e së cilës GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të KEDNJ-së, janë aktgjykimet në rastet *Demerxhiewa dhe të tjerët dhe Spasovski*.<sup>96</sup>

Me aktgjykimin në rastin *Demerxhiewa dhe të tjerët*, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës në lidhje me procedurën penale vendore. Duke e vlerësuar kërkesën e aplikantëve për dëmshpërblim, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se dëmi jo material që aplikantët e pësuan për shkak të shkeljes së konstatuar të nenit 6 të KEDNJ-së, në parim, korrigjohet më së miri duke e përsëritur procedurën e kontestuar në nivel nacional (paragrafi 33 i aktgjykimit). Gjithashtu, duke iu referuar pikëpamjeve të shprehura në aktgjykimin e lëndës *Kostadin Mihaylov v. Bulgaria*<sup>97</sup>, në paragrafin 34 të këtij aktgjykimi, GJEDNJ-ja ka theksuar se mënyra më e përshtatshme e dëmshpërblimit në rastet në të cilat është konstatuar shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë, në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, si rregull, do të ishte e përsëritja e procedurës brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe rishqyrtimi i lëndës në përputhje me të gjitha garancitë për gjykim të drejtë.

GJEDNJ-ja kishte një qasje të ngjashme në aktgjykimin Spasovski, ku konstatoi shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë nga neni 6 i KEDNJ-së, por këtë herë në kontekst të procedurës civile vendore.

Në një sërë aktgjyimesh kundër shtetit në të cilat GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6 paragrafi 1 pikat 1 dhe 3 (d) të KEDNJ-së, gjegjësisht të së drejtës së aplikantëve për gjykim të drejtë për shkak se nuk iu ishte mundësuar t'i marrin në pyetje dëshmitarët e prokurorisë ose për t'i dëgjuar dëshmitarët e mbrojtjes, GJEDNJ-ja ose drejtpërdrejt i referohet mundësisë ligjore për përsëritjen e procedurës në bazë të aktgjykimit të KEDNJ-së me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së, si formë më e përshtatshme. e dëmshpërblimit (për shembull, në rastin *Atanasov* (nr. 2)<sup>98</sup> dhe *Dushko Ivanovski*<sup>99</sup>) ose vetëm mundësisë ligjore në legjislacionin penal, që aktgjykimin i GJEDNJ-së të jetë bazë për përsëritjen e procedurës

<sup>96</sup> Demerxhiewa dhe të tjerët, nr. 19315/06, aktgjykimin i datës 10 qershor 2010 dhe Spasovski, nr. 45150/05, aktgjykimin i datës 10 qershor 2010.

<sup>97</sup> *Kostadin Mihaylov v. Bulgaria*, no. 17868/07, §§ 59-60, 27 March 2008. Në paragrafin 60 të *Kostadin Mihaylov v. Bulgaria* konkludohet: "Për këto arsye, gjykata është e mendimit se mënyra më e përshtatshme e dëmshpërblimit në rastet kur konstatohet se aplikanti nuk ka pasur qasje në gjykatë, në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës, është, si rregull, përsëritja e procedurës brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe rivlerësimi i rastit duke iu përmbajtur të gjitha kërkesave për gjykim të drejtë (shih *Lungoci v. Romania*, no. 62710/00, § 56, 26 January 2006; dhe *Yanakiev v. Bulgaria*, no. 40476/98, § 90, 10 August 2006)."

<sup>98</sup> *Atanasov* (nr. 2), nr. 41188/06, aktgjykimin i datës 19 prill 2011, paragrafët 25 dhe 43

<sup>99</sup> *Dushko Ivanovski*, nr. 10718/05, aktgjykimin i datës 24 prill 2014, paragrafët 33 dhe 64

penale vendore (në *Papadakis*<sup>100</sup> dhe në *Iljazi*<sup>101</sup>).

Mirëpo, në shumicën e aktgjyimeve të këtij grupi, GJEDNJ-ja as që e përmend mundësinë ligjore në legjislacionin penal vendor për të përsëritur procedurën në bazë të aktgjykimit të GJEDNJ-së, me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së, e as për përsëritjen e procedurës si masë më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes së konstatuar. I tillë është, për shembull, rasti me aktgjykimet e shqiptuara në rastet: *Asani*,<sup>102</sup> *Smičkovski*,<sup>103</sup> *Ziberi*,<sup>104</sup> *Janevski*,<sup>105</sup> *Trampevski*<sup>106</sup> dhe *Boshkoski*<sup>107</sup>.

Megjithatë, mungesa e përmendjes nga GJEDNJ-ja në aktgjykimet e saj me të cilat konstatonte shkelje të KEDNJ-së për mundësinë e përsëritjes së procedurës së kontestuar gjyqësore vendore nuk do të thotë se me këtë aplikantët privohen ose duhet të privohen nga mundësia e përsëritjes së saj duke u bazuar në aktgjykimin e GJEDNJ-së. Në fakt, kjo nuk duhet të çojë në refuzimin ose hedhjen poshtë në mënyrë automatike të kërkesave të tyre të mundshme për përsëritjen e proceseve të kontestuara vendore, të cilat janë parashtruar në përputhje me legjislacionin vendor, për sa kohë që nevoja për përsëritje lind nga qëllimet e ekzekutimit të aktgjykimit të GJEDNJ-së, duke i marrë parasysh arsyet për të cilat është konstatuar shkelja e KEDNJ-së.

Ndonëse duket se praktika më e re gjyqësore vendore nuk nxjerr në pah probleme në këtë kuptim, megjithatë, duhet përmendur se në praktikën vendore ka shembuj që tregojnë rrezikun e kuptimit joadekuat të institutit "përsëritje e procedurës pas aktgjykimit të GJEDNJ-së". Kështu, për shembull, në aktgjykimin e GJEDNJ-së kundër shtetit, në rastin *Naumoski*<sup>108</sup> është konstatuar shkelje e dyfishtë e nenit 6 të KEDNJ-së në një kontest në lidhje me punën për shkak të kohëzgjatjes së gjatë të procedurës, si dhe për shkak të shkeljes së parimit të kundërthënies së procedurës për shkak të dështimit të gjykatave vendore për t'ia dorëzuar aplikantit parashtrësën e palës kundërshtare, të parashtruar si përgjigje ndaj ankesës së tij në gjykatën e shkallës së dytë. Aplikanti parashtrroi propozim për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore, e cila u refuzua. Kur vendosi për propozimin, megjithëse gjykata vendore konstatoi se propozimi për përsëritjen e procedurës mbështetej në aktgjykimin e GJEDNJ-së, ajo megjithatë arriti në përfundimin se "faktet të cilave u referohet aplikanti – aktgjykimin i GJEDNJ-së dhe mosdorëzimi te paditësi i përgjigjes së të paditurit në lidhje me ankesën, në asnjërin nga pikat nga 1 deri në 10 të nenit 392 paragrafi 1 të Ligjit për

<sup>100</sup> *Papadakis*, nr. 50254/07, aktgjykimin i datës 26 shkurt 2013, paragrafi 74

<sup>101</sup> *Iljazi*, nr. 56539/08, aktgjykimin i datës 3 tetor 2013, paragrafi 33.

<sup>102</sup> *Asani*, nr. 27962/10, aktgjykimin i datës 1 shkurt 2018

<sup>103</sup> *Smičkovski*, nr. 15477/14, aktgjykimin i datës 5 korrik 2018

<sup>104</sup> *Ziberi*, nr. 27866/02, aktgjykimin i datës 5 korrik 2007

<sup>105</sup> *Janevski*, nr. 30259/15, aktgjykimin i datës 19 nëntor 2020

<sup>106</sup> *Trampevski*, nr. 4570/07, aktgjykimin i datës 10 korrik 2012

<sup>107</sup> *Boshkoski*, nr. 71034/13, aktgjykimin i datës 4 qershor 2020

<sup>108</sup> *Naumoski*, nr. 25248/05, aktgjykimin i datës 27 nëntor 2012

Procedurën Kontestimore<sup>109</sup>, nuk parashikohen si bazë ligjore sipas së cilës mund të kërkohej përsëritja e procedurës.”

Së pari, ky arsyetim tregon ekzistencën e moskuptimit të mjaftueshëm të institutit “përsëritje e procedurës në bazë të aktgjykimit të GJEDNJ-së” kur është konstatuar shkelje e KEDNJ-së, i cili synon ta korigjojë situatën individuale të aplikantit dhe të sigurojë aq sa është e mundur *resitutio in integrum* gjegjësisht kthimin e aplikantit në gjendjen në të cilën ka qenë para se të ndodhte shkelja e konstatuar e KEDNJ-së, dhe në këtë mënyrë të eliminohen shkeljet e konstatuara të KEDNJ-së. Së dyti, me të neglizhohet neni 400 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili e parasheh aktgjykimin e GJEDNJ-së, me të cilin është konstatuar shkelje e KEDNJ-së, si bazë e veçantë për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore. Së treti, duket se ndoshta imponohet një dilemë (gjithsesi e panevojshme) për sa i përket asaj se a mund shkelja e KEDNJ-së të paraqitet dhe a mjafton të paraqitet si bazë e vetme për të kërkuar përsëritje të procedurës së kontestuar vendore ose nëse ajo duhet të kombinohet ose të bashkohet me arsye të tjera shtesë për përsëritjen e procedurës (për shembull, në kontekstin e rastit konkret të parashikuar në nenin 392 të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

<sup>109</sup> Në nenin 392 të Ligjit për Procedurën Kontestimore thuhet:

- (1) Procedura e cila me vendim të gjykatës ka përfunduar në mënyrë të plotfuqishme, mund të përsëritet me kërkesë të palës nëse:
  - 1) në marrjen e vendimit ka marrë pjesë gjyqtari, përkatësisht gjyqtari porotë, i cili sipas ligjit është dashur të përjashtohet (neni 64), gjegjësisht i cili është përjashtuar me vendim të gjykatës;
  - 2) ndonjëri nga palët, me veprim të kundërligjshëm, nuk i është dhënë mundësia të argumentojë para gjykatës, e sidomos për shkak të mosdorëzimit të parashtrës;
  - 3) në procedurë, si paditës ose i paditur ka marrë pjesë personi i cili nuk mund të jetë palë në procedurë ose nëse pala që është person juridik nuk është përfaqësuar nga personi i autorizuar, nëse pala e paafte në procedurën kontestimore nuk është përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, nëse përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht i autorizuar i palës, nuk ka pasur autorizimin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës ose për veprime të veçanta në procedurë, nëse zhvillimi i procedurës, gjegjësisht kryerja e veprimeve të veçanta në procedurë, nuk ka qenë e miratuar në mënyrë shtesë;
  - 4) vendimi i gjykatës bazohet në dëshmi të rreme të dëshmitarit ose ekspertit;
  - 5) vendimi i gjykatës bazohet në dokument që është i falsifikuar ose në të cilin është vërtetuar përmbajtje e pavërtetë;
  - 6) vendimi i gjykatës është marrë për shkak të një vepre penale: të gjyqtarit, përkatësisht gjyqtari porotë, të përfaqësuesit ligjor ose të të autorizuarit të palës, të palës kundërshtarë ose të ndonjë personi të tretë;
  - 7) pala fiton mundësinë ta shfrytëzojë vendimin e plotfuqishëm të gjykatës, i cili është marrë më parë ndërmjet palëve të njëjta për kërkesën e njëjtë;
  - 8) vendimi i gjykatës bazohet në një vendim tjetër të gjykatës ose në vendimin e ndonjë organi tjetër dhe ai vendim në mënyrë të plotfuqishme do të ndryshohet, anulohet, përkatësisht shpallet i pavlefshëm;
  - 9) pala mëson për fakte të reja ose gjen ose fiton mundësinë për të shfrytëzuar prova të reja në bazë të të cilave ka mundur të merret vendim më i favorshëm për palën nëse ato fakte ose prova do të ishin përdorur në procedurën e mëparshme dhe
  - 10) me vendim të organit kompetent është vendosur në mënyrë shtesë dhe të plotfuqishme për një çështje të mëparshme (neni 11 paragrafët (1) dhe (2)) në të cilin bazohet vendimi i gjykatës.
- (2) Procedura e përfunduar në mënyrë të plotfuqishme me aktgjykim në bazë të pranimit fajit, aktgjykim në bazë mohimit të fajit, aktgjykim për shkak të mosparashtrimit të përgjigjes ndaj padisë dhe aktgjykim për shkak të mungesës, nuk mund të përsëritet për arsyet e paragrafit (1) pikat 8, 9 dhe 10 të këtij neni.
- (3) Procedura e përfunduar në mënyrë të plotfuqishme me aktgjykim në bazë të pranimit të fajit dhe me aktgjykim në bazë të mohimit fajit, mund të përsëritet sepse deklarata e pranimit të fajit, përkatësisht e mohimit të fajit, është dhënë gabimisht ose nën ndikimin e detyrimit ose mashtrimit.

Në këtë kuptim, duhet pasur parasysh në mënyrë të veçantë se, si çdo bazë tjetër e parashikuar me ligj për përsëritjen eventuale të procedurës vendore (pavarësisht nëse bëhet fjalë për legjislacion civil-procedural, penal-procedural apo administrativ-procedural), ashtu edhe aktgjykimi i GJEDNJ-së me të cilin konstatohet shkelje e KEDNJ-së, është bazë e mjaftueshme në vetvete për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore, e cila parashikohet në të gjitha ligjet procedurale dhe gjykata vendase duhet ta vlerësojë, ndër të tjera, në dritën e konkluzioneve të GJEDNJ-së në aktgjykimin e saj, natyrës së shkeljes dhe frymës së aktgjykimit të GJEDNJ-së, për të vlerësuar nëse do ta lejojë përsëritjen.

Po ashtu problematik, si në rastin e sipërpërmendur të *Naumoskit*, është edhe rasti me vendimin e gjykatës vendore për të refuzuar si të pabazuar kërkesën për përsëritjen e procedurës penale vendore ndaj aplikantit në rastin *Papadakis*.<sup>110</sup> Konkretisht, gjykata penale vendore mori qëndrimin se “madje edhe në procedurën e përsëritur në të cilën do t’i mundësohej të dënuarit dhe mbrojtësit të tij ta pyesin drejtpërdrejt dëshmitarin, gjendja faktike nuk do të ndryshonte, gjegjësisht nuk mund të pritët që të merret aktgjykim që do të bazohej vetëm në deklaratën e dëshmitarit, kështu që do të pritej që dëshmitari të lirohej nga akuza, gjegjësisht të dënohej me një ligj më të lehtë. Aq më tepër që nga ngjarja penale-juridike ka kaluar një periudhë më e gjatë kohore, duke pasur parasysh natyrën e vendit të punës së dëshmitarit, gjegjësisht faktin se ai ka qenë i punësuar në Agjencia amerikane për luftë kundër drogës - DEA, këshilli konsideron se nuk mund të pritët se do të sigurohet pjesëmarrja në shqyrtimin kryesor, se dëshmitari do t’i kujtohet ngjarja në detaje ose se do ta ndryshojë dëshminë e tij dhe do ta vë në pikëpyetje vërtetësinë e saj”.

Përkundrazi, në këto raste, duke supozuar se propozimet për përsëritjen e procedurës do të miratohen për shkak se janë parashtruar në përputhje me kushtet e parashikuara në legjislacionin vendor (brenda afatit kohor të parashikuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore ose në kushte kur nuk ka ndodhur parashkrimi (vjetërsimi absolut) i ndjekjes penale), procesi i ekzekutimit kërkon përsëritjen e procedurës vendore në të cilën do të eliminoheshin ose shteti do të demonstronte se i ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t’i eliminuar shkeljet e konstatuara të KEDNJ-së, që nuk është patjetër e thënë, por mund të çojë në një rezultat të ndryshëm të procedurës kontestuese.

Nga ana tjetër, ka **shembuj pozitivë** në praktikën gjyqësore vendore, ku pavarësisht mungesës së referimit qoftë në drejtim të dispozitave përkatëse ligjore për përsëritjen e procedurës, qoftë në drejtim të referimit për mundësinë e përsëritjes së procedurës së kontestuar vendore, si formë e dëmshpërblimit, kërkesat e parashtruara për përsëritjen e procedurave

<sup>110</sup> Në rastin *Papadakis*, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se prova kundër aplikantit e nxjerrë përmes marrjes në pyetje të një dëshmitari që ishte agjent i fshehtë në një operacion për kontrabandë të drogës, ka qenë prova vendimtare për dënimin e aplikantit në vitin 2007. Aplikanti dhe mbrojtja e tij nuk patën mundësi në asnjë fazë të procedurës kundër tij të përballen dhe ta marrin në pyetje dëshmitarin e prokurorisë. Koha prej një ore që iu la në dispozicion nga gjykata vendore e shkallës së parë për t’i përgatitur pyetjet që ata do të donin t’ia bënin dëshmitarit me shkrim, nga GJEDNJ-ja u vlerësua si e pamjaftueshme, duke e vendosur kështu aplikantin në një pozicion në të cilin, praktikisht i është hequr e drejta për t’i kundërshtuar provat kundër tij. Kështu, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se në këtë rast nuk kishte faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues, e as garanci të forta procedurale që do të siguronin një vlerësim të drejtë dhe të duhur të vërtetësisë së dëshmisë së agjentit të fshehtë si dëshmitar kundër të akuzuarit.

të kontestuara vendase kanë rezultuar me procedurë të përsëritur në kontekstin e së cilës janë eliminuar shkeljet e konstatuara me aktgjykimin e GJEDNJ-së ose nëse përsëritja nuk është objektivisht e mundur në rrethana specifike të rastit (si p.sh., për shkak të shfuqizimit të të ashtuquajturit Ligji i Lustrimit), ato kërkesa rezultuan me anulimin e vendimeve të kontestuara të gjykatave vendore (si në rastin e *Karajanov*<sup>111</sup>). E gjithë kjo është në funksion të procesit të suksesshëm të ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së, i cili nuk mbetet pa u vënë re nga Komiteti i Ministrave në procesin e mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së.

Çështja për atë se kur fillon të rrjedhë afati për parashtrimin e propozimit për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore në lidhje me të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të KEDNJ-së, paraqitet si e diskutueshme në vende të caktuara në praktikën e deritanishme gjyqësore vendore kur bëhet fjalë për lëndët civile dhe administrative; ndërsa kjo nuk ndodh kur bëhet fjalë për lëndët penale sepse në LPP nuk ka kufizim kohor për mundësinë e përsëritjes së procedurës penale të kontestuar vendore.

Në disa lëndë të Maqedonisë së Veriut, GJEDNJ-ja e përjashtoi nevojën për të përsëritur procedurën e kontestuar vendore. I tillë është rasti kundër shtetit, *Velinov*,<sup>112</sup> ku Gjykata arriti në përfundimin se në rrethanat specifike të rastit, do të ishte një barrë e tepërt për aplikantin që t'i kërkohej atij të inicioje përsëritje të procedurës së kontestuar vendore për kompensimin e dëmit në lidhje me të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të së drejtës për liri dhe siguri nga neni 5 dhe më konkretisht nga neni 5 paragrafi 5 i KEDNJ-së, i cili e garanton të drejtën e kompensimit të dëmit në rast të privimit të pajustificuar nga liria, për arsye se pavarësisht se gjykatat vendore konstatuan se aplikanti nuk ishte i njoftuar për arsyet e privimit të tij nga liria, ato megjithatë e refuzuan kërkesën e tij për dëmshpërblim.

Në fund, në lëndët kundër shtetit, GJEDNJ-ja e shqyrtoi dhe vuri në dukje mundësinë e përsëritjes së procedurës edhe në kontekst të kërkesës për kompensimin e dëmit material në rast të shkeljes së nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili e garanton të drejtën e pronës. I tillë është aktgjykimi në lëndën *Strezovski dhe të tjerët*,<sup>113</sup> ku GJEDNJ-ja, në dritën e rrethanave specifike, nuk mundi ta vlerësojë dëmin e mundshëm material.

Kur bëhet fjalë për **përsëritjen e proceseve gjyqësore pas vendimit të GJEDNJ-së për deklaratën e njëanshme**, është me rëndësi të theksohet se mungesa e dispozitave eksplicite në Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe në Ligjin për Procedurën Penale që do ta parashihnin mundësinë që edhe në këto dy ligje procedurale si bazë për përsëritjen e procedurës të përmendet vendimi i GJEDNJ-së, i marrë në bazë të deklaratës së njëanshme, gjegjësisht deklaratës së njëanshme të shtetit, me të cilën ajo e pranon shkeljen e KEDNJ-së, siç është bërë në Ligjin për Kontestet Administrative, por nuk do të thotë se praktika gjyqësore vendore pengohet të përgjigjet në këtë çështje ligjore.

<sup>111</sup> *Karajanov*, nr. 2229/15, aktgjykimi i datës 6 prill 2017. Në këtë aktgjykim, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të padrejtësisë së procedurës së lustrimit në tërësi dhe shkeljes së nenit 8 të KEDNJ-së (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

<sup>112</sup> *Velinov*, nr. 16880/08, aktgjykimi i datës 19 shtator 2013, paragrafi 74.

<sup>113</sup> *Strezovski dhe të tjerët*, nr. 14460/16 dhe 7 kërkesa të tjera, aktgjykimi i datës 27 shkurt 2020, paragrafi 95.

Në fakt, për këtë aludon edhe aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin *Prodanov*<sup>114</sup> me të cilin GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të KEDNJ-së pasi shqyrtoi a ka bazë kërkesa, pasi aplikanti më parë kishte refuzuar të binte në ujdi me shtetin dhe i sugjeroi GJEDNJ-së që të mos e pranonte deklaratën e njëanshme të shtetit me të cilën e pranoi shkeljen e KEDNJ-së sepse nuk përbën bazë për përsëritjen e procedurës vendore, me ç' rast aplikanti do të privohej nga mundësia për të kërkuar me sukses *restitutio in integrum*. Në këtë rast, GJEDNJ-ja filloi shqyrtimin meritor dhe vlerësimin a ka bazë aplikimi dhe pretendimet të theksuara në të, duke pasur parasysh se shteti nuk ka treguar para GJEDNJ-së se Ligji për Procedurën Kontestimore i vitit 2005 përmban dispozita që parashikojnë mundësinë e përsëritjes së procedurës së kontestuar vendore në bazë të vendimit të GJEDNJ-së pas deklaratës së njëanshme të deklaruar nga shteti dhe as nuk e ka vënë në dukje praktikën gjyqësore vendore se procedura civile mund të përsëritet, në rast të vendimit të GJEDNJ-së me të cilin pranohet deklarata e njëanshme e shtetit dhe lënda hiqet nga lista e lëndëve pranë GJEDNJ-së (shih, a *contrario*, vendimi i GJEDNJ-së për heqjen nga lista të lëndëve pranë GJEDNJ-së), në bazë të deklaratës së njëanshme të shtetit, lëndët në rastet e *Milçin dhe Psaltirov*.<sup>115</sup> Gjatë marrjes së vendimit, gjykata i ka marrë parasysh ndryshimet në legjislacionin vendore (ose më konkretisht në Ligjin për Kontestet Administrative) të cilat kanë mundësuar përsëritjen e procedurës edhe pas vendimit të GJEDNJ-së të marrë pas deklaratës së njëanshme.

Megjithatë, duhet pasur parasysh se ekziston praktika gjyqësore vendore për sa i përket procedurave civile, sipas së cilës vendimi i GJEDNJ-së për pranimin e deklaratës së njëanshme nga ana e shtetit me të cilën pranohet shkelja e KEDNJ-së mund të jetë bazë për përsëritjen e procedurës së kontestuar vendore. Kjo praktikë gjyqësore është zhvilluar në bazë të vendimit të GJEDNJ-së në rastin *Spirovski*.<sup>116</sup> Megjithatë, këtu bëhet fjalë për një shembull të izoluar në një rast konkret, kështu që zhvillimi i mëtejshëm i praktikës gjyqësore vendore mbetet të tregojë nëse kjo tendencë e veprimit do të ruhet edhe në të ardhmen.

Në praktikën e Maqedonisë së Veriut është regjistruar edhe një rast, *Fetaovski*, në të cilin mos përsëritja gjyqësore vendore me të cilën lidhen shkeljet e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, ishte arsyeja për fillimin e një procedure të re para GJEDNJ-së. Në fakt, në procedurën fillestare para saj, Gjykata ka nxjerrë një aktgjykim, me të cilin përveç shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, është konstatuar edhe shkelja e të drejtës së aplikantit për qasje në gjykatë në kontekstin e procedurës vendore për dëmshpërblim kundër Inspektoratit Veterinar në Kumanovë. Shkelja kryesore e të drejtës për qasje në gjykatë si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë ka dalë nga fakti se Gjykata e Apelit në Shkup e refuzoi ankesën e aplikantit kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore Kumanovë, si i marrë jo në kohë, e në bazë të të dhënave në librin e evidencës së lëndëve të gjykatës së shkallës së parë, ndonëse i është dorëzuar një kopje e ankesës, e cila sipas vulës pranuese të

<sup>114</sup> *Prodanov*, nr. 73087/12, aktgjykimi i datës 10 qershor 2021, paragrafët 20-25.

<sup>115</sup> *Milçin dhe Psaltirov*, nr. 17607/15 dhe 32576/15, vendim i datës 16 shtator 2021.

<sup>116</sup> *Spirovski*, nr. 60266/14, vendim i datës 12 shkurt 2019. Në këtë kontekst, shih Vendimin e Gjykatës Themelore Civile 2 P4-6/13a, të datës 9 korrik 2019, me të cilin lejohet përsëritja e procedurës vendore në bazë të vendimit të GJEDNJ-së, pas së cilës procedura e përsëritur përfundon me aktgjykimin GZH nr. 702/20 të datës 2 shtator 2020 në Gjykatën e Apelit në Shkup.



Gjykatës Themelore të Kumanovës, ishte dorëzuar brenda afatit ligjor.<sup>117</sup>

Me rastin e aktgjykimit të Gjykatës, të datës 19 qershor 2008, aplikanti ka kërkuar përsëritjen e procedurës kontestuese në bazë të nenit 400 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Ai ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Kumanovë që t'i anulojë aktgjykimet e dhëna në procedurën kontestimore për kompensimin e dëmit, si dhe ta aprovojë kërkesën e tij për kompensim të dëmit në procedurë të përsëritur. Përkundrazi, Gjykata Themelore në Kumanovë e refuzoi propozimin e aplikantit për përsëritjen e procedurës si të pabazuar, gjë që u vërtetua me aktgjykimin e mëvonshëm të Gjykatës së Apelit në Shkup. Edhe pse nga gjendja e vërtetuar faktike dhe shkelja e konstatuar, në aktgjykimin e GJEDNJ-së nevoja për përsëritjen e procedurës ka qenë e padiskutueshme, për çka ishin plotësuar edhe kushtet ligjore, gjatë marrjes së vendimit, Gjykata Themelore ka dhënë interpretim jo adekuat të aktgjykimit të GJEDNJ-së, e më pas pa arsytim të mjaftueshëm dhe të arsyeshëm të pranueshëm konstatoi se propozimi për përsëritjen e procedurës ishte i pabazuar dhe e refuzoi atë për arsye që mbeten të paqarta dhe të shpjeguara në mënyrë të pamjaftueshme. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit, në vend të përkthimit të aktgjykimit në gjuhën maqedonase, i cili është i publikuar edhe në ueb-faqen e Ministrisë së Drejtësisë, si dëshmi e ka marrë parasysh përkthimin joadekuat të bërë nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor, teksti i të cilit ishte deri diku i pasaktë dhe ndryshonte nga teksti i përkthimit të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ishte dorëzuar si provë në gjykatë nga ana e aplikantit.

Këto rrethana i referohen pretendimeve të ankesës të theksuara në aplikimin e dytë të parashtruar në GJEDNJ nga i njëjti aplikant, në të cilën ai u ankua edhe një herë për shkelje të nenit 6 të Konventës dhe për të cilën do të krijohet lëndë e re kundër shtetit me të njëjtin titull - *Fetaovski*. Gjatë dorëzimit të këtij aplikimi në përgjigjen e Qeverisë, Regjistri i GJEDNJ-së, ndër të tjera, i kërkoi Qeverisë të deklarohej në lidhje me refuzimin e gjykatave vendore për ta përsëritur procedurën në kontekstin e vendimit të sipërpërmendur të GJEDNJ-së në rastin *Fetaovski*, duke iu referuar edhe aktgjykimit në rastin *Bochan v. Ukraine* (no. 2).<sup>118</sup>

Për sa i përket aplikimit të dytë, duhet të merret parasysh praktika gjyqësore relevante e GJEDNJ-së, duke përfshirë edhe faktin se bëhej fjalë për rrethana të ngjashme, gjegjësisht edhe në rastin *Fetaovski*, ngjashëm si edhe në rastin *Bochan v. Ukraine* (no. 2), trajtohet çështja e drejtësisë së procedurës për përsëritjen e procedurës në të cilën përcaktohen të drejtat civile të aplikantit, të cilat mund të hyjnë në kuadër të mbrojtjes së pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Për më tepër, në rastin *Fetaovski*, për dallim nga *Bochan v. Ukraine* (no. 2), GJEDNJ-ja nuk shqiptoi dëmshtëpërbllim të drejtë, gjegjësisht zhdëmtim për dëmin jo material (duke marrë parasysh se aplikanti nuk e kërkoi atë). Mu për këtë arsye, duket se përsëritja e procedurës si masë individuale ishte e vetmja mënyrë për të mundësuar ekzekutimin efikas të aktgjykimit.

Prandaj, është plotësisht e kuptueshme që është arritur një ujdi miqësor me aplikantin, me

<sup>117</sup> Për më shumë detaje, shih *Fetaovski*, nr. 10649/03, aktgjykimi i datës 19 qershor 2008.

<sup>118</sup> Për një pasqyrë të plotë në komunikimin me Qeverinë, shih Pasqyrën e fakteve (Statement of Facts) të datës 19 maj 2015, që është në dispozicion në <https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22fulltext%22:%22Fetaovski%22,%22documentcollectionid%22:%22COMMUNICATEDCASES%22,%22itemid%22:%22001-155315%22}}>.

anë të së cilës shteti obligohet që t'i paguajë aplikantit ex gratia një shumë prej 3.300 eurosh, si zhdëmtim për dëmin e pësuar material dhe jo material dhe shpenzimet ligjore dhe të tjera, ndërsa aplikanti, nga ana e tij ka pranuar të heqë dorë nga çdo pretendim i mëtejshëm nga shteti në lidhje me faktet e paraqitura në këtë aplikim.<sup>119</sup>

<sup>119</sup> Shih *Fetaovski*, nr. 71962/10, vendim i datës 23 shkurt 2016.

## V. Sfidat në përsëritjen e proceseve gjyqësore vendore në lëndët civile dhe penale

Përvojat me përsëritjen e proceseve gjyqësore, pas konstatimit të shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sjellin me vete një sërë sfidash praktike dhe procedurale.

### V.1. Përsëritja e procedurave civile

Si pengesa më të rëndësishme për shtetet në lidhje me përsëritjen e procedurave gjyqësore në lëndët civile konsiderohen parimi i çështjes së gjykuar (*res judicata*), parimi i sigurisë juridike, mbrojtja e palëve të treta që kanë vepruar në mirëbesim (*bona fide*), si dhe pamundësia praktike për të korrigjuar mangësitë në vendimet e gjykatave vendore të marra shumë vite më parë, duke pasur parasysh natyrën dinamike të marrëdhënieve juridiko-private. Këto aspekte janë të rëndësishme edhe në lidhje me përsëritjen e procedurave administrativo-gjyqësore.

Së pari, përsëritja e **procedurave civile** me rastin e një shkeljeje të konstatuar të Konventës, mund të jetë problematike nga pikëpamja se lëndët civile zhvillohen shpesh për të zgjidhur kontestet ndërmjet palëve që kanë interesa të kundërta. Prandaj, kur njëra nga palët para Gjykatës e konteston përputhshmërinë me Konventën të procedurës së zbatuar ose të vendimit të marrë, rezultati i procedurës para Gjykatës i prek të drejtat dhe interesat e palëve të tjera, duke përfshirë edhe ato të atyre të drejtat e të cilëve në po atë procedurë janë përcaktuar, gjegjësisht janë njohur me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Edhe pse GJEDNJ-ja e shqyrton lidhjen vertikale (lidhjen ndërmjet aplikantit dhe shtetit) dhe i përcakton shkeljet e mundshme të Konventës që mund t'i atribuohen autoriteteve shtetërore, aktgjykimi i GJEDNJ-së me të cilën konstatohet shkelje e të drejtave të aplikantit në kuadër të procedurës civile ose shkelje për shkak të vendimit gjyqësor që është marrë në një lëndë civile, do të ndikojë edhe në mbrojtjen e të drejtave që u jepet palëve të tjera në procedurë dhe domosdoshmërisht e ka edhe dimensionin e vet horizontal, që ndikon edhe në marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet palëve private. Kjo është edhe më shumë kështu edhe si rezultat i zgjerimit të vazhdueshëm në praktikën gjyqësore të diapazonit të zbatimit të të drejtave nga Konventa në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet palëve të së drejtës private (*Drittwirkung*).

Efekti i aktgjykimit të GJEDNJ-së, në këtë kuptim, do të jetë edhe më thelbësor nëse konstatimi i shkeljes së Konventës së kryer në procedurë civile ose që rezulton nga një vendim gjyqësor i marrë në një lëndë civile, do të çonte në rihapjen e procedurës gjyqësore në fjalë. Aq më tepër, i tillë është rasti kur vetë aktgjykimi i GJEDNJ-së i referohet mundësisë për përsëritjen e procedurës, për të mundësuar ekzekutimin e aktgjykimit përkatës të GJEDNJ-së.

Pastaj, veçanërisht e pranishme është frika për implikimet e mundshme të rishqyrtimit të lëndëve civile për parimet e **res judicata dhe sigurisë juridike** në paditë e përfunduara civile dhe për **interesat legjitime të palëve të treta**.

Në fakt, secila palë në procedurën civile ka të drejtë të marrë një vendim përfundimtar dhe të plotfuqishëm, i cili do të merret brenda një afati të arsyeshëm dhe i cili, madje edhe nëse është i mangët nga pikëpamja e Konventës, megjithatë, krijon pritshmëri legjitime në aspekt të sigurisë juridike, veçanërisht nëse pala kundërshtare ka vepruar me mirëbesim në një situatë kur shkeljet e Konventës nuk kanë qenë të qarta në dritën e praktikës ekzistuese të Gjykatës.

Prandaj, si një argument i fortë kundër rihapjes së procedurave civile si rezultat i aktgjykimit të Gjykatës në të cilin është konstatuar shkelje e Konventës, theksohet nevoja për të siguruar qëndrueshmërinë e vendimeve përfundimtare dhe të plotfuqishme gjyqësore, me të cilat zgjidhen rastet që përfshijnë palë private dhe interesa legjitime të të gjitha palëve në procedurë, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të neglizhohen. Në këtë kuptim, është thelbësore që ato vendime duhet të krijojnë situatë të padyshimtë dhe siguri juridike për të gjithë personat e interesuar.

Në rastin *Buchan v. Ukraine* (no. 2) GJEDNJ-ja theksoi se “shtetet duhet të vendosin se si t'i zbatojnë më mirë aktgjykimet e Gjykatës, pa i shkelur me këtë rast në mënyrë të paarsyeshme parimet e *res judicata* ose të sigurisë juridike në proceset gjyqësore civile, veçanërisht kur një proces gjyqësor i tillë ka të bëjë me palë të treta që kanë interesat e tyre legjitime që duhet mbrojtur.”<sup>120</sup>

Gjithashtu, në rastet kur për disa nga arsyet e mësipërme nuk ka pasur mundësi për përsëritje të proceseve gjyqësore civile ose administrative vendore, në disa vende parashikohet një mekanizëm për fillimin e procedurës kundër shtetit për të përcaktuar kompensimin për dëmin që është shkaktuar si pasojë e paligjshmërisë në dhënien e drejtësisë, si dhe zhdëmtimin e dëmit të pësuar nga aplikanti për shkak të humbjes së mundësisë për të përsëritur procedurën, si alternativë ndaj përsëritjes.

Përndryshe, kur në një vend të caktuar lejueshmëria e mjetit ligjor për përsëritjen e procedurës gjyqësore vendore, nga pikëpamja e respektimit të afatit kohor, lidhet me një afat që fillon të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimit të fundit të plotfuqishëm në instancën më të lartë të gjyqësore vendore, dhe ai afat është humbur, gjegjësisht ka skaduar, që ka qenë rezultat i kohëzgjatjes tepër të gjatë të procedurës para GJEDNJ-së, me ç' rast është tejkaluar afati ligjor në të cilin mund të kërkohet përsëritje, kjo mund të përfaqësojë një pengesë objektive për zbatimin e aktgjykimit. Prandaj, gjithmonë rekomandohet që afati për parashtrimin e mjetit adekuat juridik të llogaritet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të aktgjyimeve të GJEDNJ-së, gjë që, në fakt, është paraparë edhe në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut.

<sup>120</sup> *Bochan v. Ukraine* (no. 2) [GC], no. 22251/08, § 57, ECHR 2015

## V.2. Përsëritja e procedurave penale

Ndryshe nga procedurat civile në të cilat të drejtat e njëjës palë mund të bien ndesh me të drejtat e palës tjetër, konsideratat e tilla nuk janë të rëndësishme në kontekstin e **procedurave penale** nga pikëpamja e masave të ndërmara në favor të personave të akuzuar ose të dënuar, pavarësisht se mund të ketë një lloj kundërshtimi midis të drejtave të të akuzuarit ose të dënuarit, nga njëra anë, dhe të drejtave që mund t'i kërkojnë viktimat (të dëmtuarit) para gjykatave vendore, nga ana tjetër.

Si pengesa kryesore për rihapjen e procedurave penale paraqiten parimet e **res judicata dhe të sigurisë juridike** (plotfuqishmëria e aktgjyqimit dhe ndodhja e parashkrimit).

Për më tepër, ndonjëherë shfaqja eventuale e **parashkrimit (vjetërsimit) absolut të ndjekjes penale** mund të paraqitet si rrethanë objektive që do ta pengojë përsëritjen e procedurave penale të kontestuara vendase në të cilat ka ndodhur shkelja e konstatuar e KEDNJ-së dhe do ta arsyetojë mungesën e mundësisë së përsëritjes së procedurave penale në situata të tilla.<sup>121</sup>

Për t'i kapërcyer pengesat procedurale për përsëritjen e procedurave penale, siç është parimi *res judicata* i aktgjyqimeve vendore dhe **parimi ne bis in idem (ndalimi i gjyqimit ose dënimit të dyfishtë për të njëjtën çështje juridike)**, i garantuar me nenin 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës, i rëndësishëm është parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës dhe efekti i drejtpërdrejtë i aktgjyqimeve të GJEDNJ-së në rendin juridik kombëtar. Në këtë kuptim, aktgjyqimet e GJEDNJ-së duhet të konsiderohen si “dokumente ekzekutive” që kërkojnë rishikim të jashtëzakonshëm të aktgjyqimeve të kontestuara vendore.<sup>122</sup>

Vështirësitë procedurale që lidhen me rrjedhën e kohës mund të zgjidhen duke u lejuar personave të tjerë që të kërkojnë përsëritjen e procedurës, si p.sh. prokurori ose anëtarët e familjes në rast të vdekjes ose mungesës së personit të prekur.<sup>123</sup> Në rast se rrjedha e kohës ndikon në mundësinë e marrjes në pyetjeve të dëshmitarëve, përpjekjet e organeve gjyqësore për gjetjen e dëshmitarëve konsiderohen të mjaftueshme që Komiteti i Ministrave të mund ta mbyllë lëndën për të cilën bëhet fjalë.<sup>124</sup>

Përsëritja e suksesshme e një procedure të caktuar gjyqësore pas shkeljes së konstatuar të nenit 6 të KEDNJ, mund të çojë në anulimin e aktgjyqimit fillestar të kontestuar, kurse

<sup>121</sup> Gjithashtu, kërkesa për përsëritjen e procedurave penale mund të konsiderohet e papranueshme, jo vetëm nëse nuk është parashtruar në kohë, por edhe kur pasojat e shkeljes kanë pushuar së ekzistuari (Moldavia).

<sup>122</sup> Strasbourg, 12 February 2016, DH-GDR (2015)008 Rev, STEERING COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS (CDDH), COMMITTEE OF EXPERTS ON THE REFORM OF THE COURT (DH-GDR), Overview of the exchange of views held at the 8th meeting of DH-GDR on the provision in the domestic legal order for the re-examination or reopening of cases following judgments of the Court (prepared by the Secretariat), gjendet në <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680654d5a>, fq. 4, paragrafi 9 b).

<sup>123</sup> Për shembull, në Bosnje dhe Hercegovinë, Francë dhe Poloni.

<sup>124</sup> Strasbourg, 12 February 2016, DH-GDR (2015)008 Rev, STEERING COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS (CDDH), COMMITTEE OF EXPERTS ON THE REFORM OF THE COURT (DH-GDR), Overview of the exchange of views held at the 8th meeting of DH-GDR on the provision in the domestic legal order for the re-examination or reopening of cases following judgments of the Court (prepared by the Secretariat), gjendet në <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680654d5a>, fq. 5, paragrafi 10 e).

rishqyrtimi i lëndës mund të rezultojë me heqjen e mangësive të identifikuar nga Gjykata, me ç' rast rezultati përfundimtar i procedurës së përsëritur penale mund të jetë i njëjtë ose i ndryshëm (aktgjykim lirues, vërtetim i aktgjyqimit ndëshkues ose ulje, gjegjësisht heqje e dënimit). Sidoqoftë, vetë përsëritja e procedurës gjyqësore nuk nënkupton dhe **nuk paraqet asnjë garanci për rezultat të ndryshëm të procedurës gjyqësore për lëndën në fjalë.**

Pasi të lejohet përsëritja e një procedure të caktuar penale, është thelbësore që aplikanti të trajtohet me respekt të plotë për **supozimin e pafajësisë**.<sup>125</sup> Për më tepër, në shumë vende është e përcaktuar edhe **ndalimi i rreptë i ndryshimit për më heq (reformatio in pejus)** në kuadër të procedurës së përsëritur penale.<sup>126</sup>

Në kontekstin e përsëritjes së procedurës penale, është e një rëndësie të veçantë të merret në konsideratë mundësia që në sistemet ligjore kombëtare të sigurohet edhe zbatimi adekuat i parimit **beneficium cohesionis (privilegji i bashkimit)**. Kjo do të thotë se vendimi me të cilin është lejuar përsëritja e procedurës penale për aplikantin, duhet të jetë në favor edhe të personave të tjerë të akuzuar, për të cilët mund të konsiderohet se kanë qenë viktimat të asaj shkeljeje të të drejtave të tyre si edhe aplikanti, duke marrë parasysh me këtë rast kombinimin e rrethanave faktike dhe juridike të rastit. Natyrisht, realizimi i kësaj mundësie nuk është automatik në bazë të vetë vendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës për aplikantin, por lidhet me parashtrimin e kërkesave përkatëse për përsëritjen e procedurës penale në fjalë veç e veç nga secili person i prekur si i akuzuar.

<sup>125</sup> Review of the implementation of Recommendation (2000) 2 of the Committee of Ministers to the Member States on re-examination and reopening of certain cases at domestic level following judgments of the European Court of Human Rights, paragrafi 19, gjendet në <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%22Fetaovski%22%22%22documentcollectionid%22:%5B%22COMMUNICATEDCASES%22%22itemid%22:%5B%22001-155315%22%22%7D>

<sup>126</sup> Shih paragrafin 12 të të njëjtit dokument.

## VI. Vështrim përmbyllës

Procesi i ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së zakonisht përballet me sfida të ndryshme, kurse situata në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Rëndësi të veçantë për suksesin e procesit të ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së ka individualizimi, përkatësisht përshtatja e masave për ekzekutim, në përputhje me udhëzimet që i përmban aktgjykimi, gjegjësisht në frymën dhe thelbin e tij. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për arritjen e qëllimit themelor, i cili konsiston në arritjen e të ashtuquajturit *restitutio in integrum*. Përsëritja e procedurës vendore, si masë individuale, është veçanërisht efektive duke qenë se mundëson eliminimin e konsiderueshëm të shkeljes së të drejtave të njeriut, por në të njëjtën kohë i përfshin organet gjyqësore, me ç' rast ato sensibilizohen dhe edukohen.

Barra e zbatimit të masave individuale për ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së dhe në këtë kuptim edhe barra e përsëritjes së procedurave kontestuese, natyrisht që i takon në radhë të parë gjyqësorit. Metodologjia e ekzekutimit të masave individuale nënkupton: analizë të detajuar të çdo aktgjykimi, duke përcaktuar se cilat masa individuale janë të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e aktgjyqimeve dhe zbatimin e tyre. Është e nevojshme të kihet parasysh se jo çdo shkelje e përcaktuar me aktgjykim të GJEDNJ-së kërkon përsëritje të procedurës vendore. Me këtë rast, me rëndësi të veçantë është respektimi i praktikës së Komitetit të Ministrave, si autoritet kompetent për ekzekutimin dhe Rekomandimit të tij nr. R (2000) 2, gjegjësisht të kriterëve të përfshira në të.

Në fund, është e nevojshme të theksohet se ekzekutimi i aktgjyqimeve të GJEDNJ-së është i një rëndësie të veçantë për sundimin e ligjit dhe realizimin e detyrimeve juridike ndërkombëtare të shtetit. Prandaj, është e nevojshme t'i qasemi kësaj çështjeje me vëmendje të veçantë dhe të mos lejojmë që mu ekzekutimi i masave individuale të bëhet burim i ndonjë padrejtësie të re dhe i pasigurisë juridike, veçanërisht për palët e treta të interesuara. Sistemi ligjor, vendor dhe ndërkombëtar, duhet të jetë konsekuent dhe në interes të të gjitha palëve të interesuara. Edhe pse kjo duket si një detyrë e vështirë, me vullnet të mirë dhe përkushtim ndaj të drejtave të njeriut, rezultati pozitiv do të ishte më i lehtë për t'u arritur dhe më real.

### ANEKSI:

**Rekomandimi nr. R (2000) 2 i Këshillit të Evropës mbi rishqyrtimin ose rihapjen e procedurave gjyqësore për çështje të caktuara në nivel nacional pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

## KËSHILLI I EVROPËS

### KOMITETI I MINISTRAVE

**Rekomandimi nr. R (2000) 2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për rishqyrtimin ose rihapjen e procedurave gjyqësore për çështje të caktuara në nivel nacional pas një aktgjykimi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut [1] (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 janar të vitit 2000 në mbledhjen e 694-të të zëvendësministrave)**

Komiteti i Ministrave në përputhje me kushtet e nenit 15b të Statutit të Këshillit të Evropës:

- Duke pasur parasysh synimin e Këshillit të Evropës për të mundësuar një lidhje më të madhe ndërmjet anëtarëve të vet;
  - Duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejshëm "Konventa");
  - Duke vënë në dukje se në nenin 46 të Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore ("Konventa"), palët kontraktuese kanë pranuar detyrimin për të zbatuar aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Gjykata") në çdo rast në të cilën ata janë palë dhe se Komiteti i Ministrave do ta mbikëqyrë zbatimin e tij;
  - Duke pasur parasysh se në rrethana të caktuara detyrimi i mësipërm mund të kërkojë marrjen e masave, të ndryshme nga ato të parashikuara nga Gjykata në përputhje me nenin 41 të Konventës dhe/ose masa të përgjithshme që do të sigurojnë që pala e dëmtuar të vendoset, për aq sa është e mundur, në të njëjtën situatë përpara shkeljes së Konventës (*restitutio in integrum*);
  - Duke theksuar se autoritetet kompetente të shtetit të paditur duhet të vendosin se cilat masa janë më të përshtatshme për të arritur *restitutio in integrum*, duke marrë parasysh mjetet në dispozicion në përputhje me sistemin ligjor nacional;
  - Duke pasur parasysh se megjithatë, praktika e Komitetit të Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës tregon se në rrethana të jashtëzakonshme rishqyrtimi i çështjes ose rihapja e procesit gjyqësor ka rezultuar si më efektive, nëse jo edhe si mjet i vetëm për të arritur *restitutio in integrum*:
- I. I fton, duke pasur parasysh këto vëzhgime, palët kontraktuese të sigurojnë që në nivel kombëtar ekzistojnë mundësitë e duhura për të arritur, sa më shumë që të jetë e mundur, *restitutio in integrum*;

II. Në veçanti, i inkurajon palët kontraktuese t'i rishikojnë sistemet e tyre ligjore nacionale

për të përcaktuar nëse ka mundësi adekuate për rishqyrtimin e rasteve, duke përfshirë edhe rihapjen e proceseve gjyqësore, në rastet ku Gjykata ka konstatuar se ka pasur shkelje të Konventës, e veçanërisht kur:

- i. i. Pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja të rënda negative për shkak të rezultatit të vendimit nacional, të cilat nuk janë korrigjuar në mënyrë adekuate me kompensimin e drejtë dhe nuk mund të korrigjohen përveç se me rishqyrtimin e rastit dhe rihapjen e procedurës gjyqësore, dhe
- ii. Aktgjykimi i Gjykatës çon në përfundimin se:
  - a. vendimi nacional i kontestuar është (në thelb) me të drejtë në kundërshtim me Konventën, ose
  - b. shkelja e konstatuar bazohet në gabime ose mangësi të rënda procedurale që janë të një rëndësie të tillë që të ngrenë dyshime serioze mbi rezultatin e procedurave kombëtare që janë kontestuar.

## ARSYETIM

### Hyrje

1. Palët kontraktuese të Konventës kanë një liri veprimi, që i nënshtrohet mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave, për mënyrën se si do të veprojnë në përputhje me detyrimin sipas nenit 46 të Konventës “për të respektuar aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës në çdo rast në të cilën ata janë palë”.
2. Gjykata ka vlerësuar se “aktgjykimi me të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje, i imponon shtetit të paditur detyrim ligjor për t'i dhënë fund një shkeljeje të tillë dhe për të siguruar kompensim për pasojat e tij në një mënyrë që do të mundësonte të njëjtën situatë që ka ekzistuar para shkeljes së tillë” (shih, ndër të tjera, aktgjykimi i Gjykatës për rastin *Papamikalopulos kundër Greqisë* i datës 31 tetor 1995, paragrafi 34, Seria A 330-V). Në këtë rast, Gjykata e theksoi parimin e njohur juridik ndërkombëtar të *restitutio in integrum*, të cilin shpesh e ka zbatuar Komiteti i Ministrave gjatë marrjes së vendimeve të tij. Në këtë kontekst, nevoja për të përmirësuar mundësitë në përputhje me sistemet ligjore kombëtare për të siguruar zbatimin e *restitutio in integrum*, për palën e dëmtuar bëhet gjithnjë e më e qartë.
3. Edhe pse Konventa nuk përmban dispozitë që u imponon detyrim palëve kontraktuese të mundësojnë në legjislacionin e tyre nacional rishqyrtim të rastit ose rihapjen e procedurës gjyqësore, ekzistenca e një mundësie të tillë, në rrethana të veçanta, është dëshmuar të jetë një mjet i rëndësishëm dhe në disa raste, ky është mjeti i vetëm për ta arritur *restitutio in integrum*. Numri i vendeve që kanë miratuar legjislacion të veçantë që mundëson rishqyrtimin e rastit ose rihapjen e procedurës gjyqësore është në rritje. Në vende të tjera, kjo mundësi është zhvilluar nga gjykatat dhe autoritetet nacionale sipas ligjit ekzistues.
4. Rekomandimi aktual është rezultat i zhvillimeve të tilla. Ajo u bën thirrje palëve kontraktuese të sigurojnë që sistemet e tyre ligjore të përmbajnë mundësinë e nevojshme

për të arritur, sa më shumë që të jetë e mundur, *restitutio in integrum*, e veçanërisht të ofrojnë mundësi adekuate për rishqyrtimin e rasteve, duke përfshirë edhe rihapjen e procedurave gjyqësore.

5. Për sa i përket termave, rekomandimi e përdor “rishqyrtimin” si term të përgjithshëm. Termi “rihapje e procedurave gjyqësore” nënkupton rihapjen e procedurave gjyqësore si mjete specifike për rishqyrtim. Shkeljet e Konventës mund të korrigjohen duke aplikuar masa të ndryshme që shtrihen nga rishqyrtimi administrativ i rastit (për shembull, dhënia e lejes së qëndrimit që është refuzuar më parë) e deri te rihapja e plotë e procedurave gjyqësore (për shembull, në rastin e dënimit penal).
6. Rekomandimi zbatohet kryesisht për procedurat gjyqësore ku ligji ekzistues mund të paraqesë pengesën më të madhe për procedurat e reja. Megjithatë, rekomandimi është gjithashtu i zbatueshëm edhe për masat ose procedurat administrative të tjera, megjithëse pengesat e tilla ligjore janë zakonisht më pak të rëndësishme në këto fusha.
7. Së pari, ka komente konkrete që i referohen dy qëndrimeve operative të rekomandimit, e më pas edhe komente më të përgjithshme për çështjet që nuk janë trajtuar në mënyrë eksplicite në rekomandim.

### Komente mbi dispozitat operative

8. Paragrafi 1 e përcakton parimin bazë për rekomandimin se të gjitha viktimat (të dëmtuarit) e shkeljeve të Konventës duhet të kenë të drejtën, sa më shumë që të jetë e mundur, për *restitutio in integrum* efektive. Palët kontraktuese duhet, në përputhje me rrethanat, t'i rishikojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të sigurojnë se ekzistojnë mundësitë e nevojshme.
9. Paragrafi 2 i inkurajon shtetet që nuk e kanë bërë akoma një gjë të tillë, të parashikojnë mundësinë e rishqyrtimit të rasteve, duke përfshirë edhe rihapjen e procedurave nacionale, në mënyrë që t'i jepet efekt i plotë aktgjyqimeve të Gjykatës. Ky paragraf gjithashtu i përcakton rrethanat në të cilat rishqyrtimi ose rihapja është veçanërisht e rëndësishme, e në disa raste mund të jetë mjeti i vetëm për të arritur *restitutio in integrum*.
10. Praktika e organeve të Konventës ka treguar se rishqyrtimi i një rasti ka një rëndësi të madhe, kryesisht në fushën e së drejtës penale. Megjithatë, ky rekomandim nuk kufizohet vetëm në të drejtën penale, por e mbulon çdo kategori të rasteve, veçanërisht ato që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikat (i) dhe (ii). Qëllimi i këtyre kriterëve shtesë është të identifikohen ato situata të jashtëzakonshme në të cilat qëllimi i sigurimit të të drejtave të individit dhe ekzekutimi efektiv i aktgjyqimeve të Gjykatës mbizotërojnë mbi parimet që e theksojnë doktrinën e *res judicata*, në veçanti parimin e sigurisë juridike, përkundër rëndësisë së padyshimtë të këtyre parimeve.
11. Pika (i) synon të përfshijë situatën në të cilën pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja negative shumë të rënda, të cilat nuk mund të korrigjohen me kompensim të drejtë, për shkak të rezultatit të procedurave nacionale. Ai zbatohet veçanërisht për personat që janë dënuar me burgime të gjata dhe që janë ende në burg në kohën kur organet e Konventës e shqyrtojnë “rastin”. Megjithatë, ai zbatohet edhe në fusha të tjera, si për shembull kur një person privohet pa arsye nga disa të drejta civile ose politike (veçanërisht në rastin e humbjes ose mosnjohjes së zotësisë juridike ose personalitetit, deklarimit të falimentimit ose ndalimit të veprimtarisë politike), nëse personi dëbohet në kundërshtim me të drejtën

e tij/e saj për jetë familjare ose nëse fëmija pengohet padrejtësisht të kontaktojë me prindërit e tij/e saj. Vetëkuptohet se duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë shkak-pasojë ndërmjet shkeljes së konstatuar dhe vuajtjes së vazhdueshme të palës së dëmtuar.

12. Pika (ii) synon të tregojë, në rastet kur janë plotësuar kushtet e përmendura më sipër, llojin e shkeljeve në të cilat rishqyrtimi i rastit ose rihapja e procedurës ka një rëndësi të veçantë. Shembuj të situatave të tilla janë: (a) dënimet penale që shkelin nenin 10 për shkak se deklaratat që cilësohen si kriminale nga autoritetet nacionale përbëjnë ushtrim legjitim të lirisë së shprehjes së palës së dëmtuar ose shkelje të nenit 9 për shkak të sjelljes që cilësohet si kriminale përbën ushtrim legjitim të lirisë së fesë. Shembuj të situatave në pikën (b) janë ato situata kur pala e dëmtuar nuk ka kohë dhe mundësi ta përgatisë mbrojtjen e tij në procedurat penale, ku aktgjykimi bazohet në deklarata të nxjerra përmes torturës ose nga material për të cilat pala e dëmtuar nuk ka pasur mundësi ta konfirmojë ose në procedura civile ku palët nuk janë trajtuar me respektin e duhur në kuptim të parimit të barazisë. Të gjitha këto mangësi, siç shihet nga vetë teksti i rekomandimit, duhet të jenë aq serioze sa të hedhin dyshime serioze mbi rezultatin e procedurave kombëtare.

### Vëzhgime të tjera

13. Rekomandimi nuk e trajton problemin se kush duhet të autorizohet për të kërkuar rihapjen e procedurës gjyqësore apo rishqyrtimin e rastit. Duke marrë parasysh se qëllimi kryesor i rekomandimit është sigurimi i mbrojtjes adekuate të viktimave të disa shkeljeve të rënda të Konventës, të përcaktuara nga ana e Gjykatës, logjika e sistemit nënkupton se individët e prekur duhet të kenë të drejtën t'i parashtrojnë kërkesat e nevojshme në gjykatën kompetente ose te ndonjë autoritet tjetër nacional. Megjithatë, duke marrë parasysh traditat e ndryshme të palëve kontraktuese, në rekomandim nuk është përfshirë asnjë dispozitë që do të kishte një veprim të tillë.
14. Rekomandimi nuk trajton problemin e veçantë të "rasteve masive", gjegjësisht rastet kur disa mangësi të caktuara strukturore çojnë në shkelje të shumta të Konventës. Në raste të tilla, në parim është më mirë t'i lihet shtetit të prekur që të vendosë nëse rihapja ose rishqyrtimi i rastit është një zgjidhje realiste apo është e përshtatshme të zbatohen masa të tjera.
15. Në procesin e përgatitjes së rekomandimit, u konfirmua se rihapja ose rishqyrtimi mund të shkaktojë probleme për palët/personat e tretë, veçanërisht nëse ata kanë fituar të drejta me vullnet të mirë. Megjithatë, ky problem ekziston tashmë në zbatimin e rregullave të zakonshme nacionale për rishqyrtimin e rasteve apo rihapjen e procedurave. Zgjidhjet që janë aplikuar në këto raste duhet të jenë të zbatueshme, të paktën sipas parimit mutatis mutandis, në rastet kur është urdhëruar rishqyrtimi ose rihapja me qëllim që t'u jepet efekt vendimeve të Gjykatës.

Në rastet e rishqyrtimit ose rihapjes së proceseve gjyqësore për të cilat Gjykata ka dhënë një kompensim të drejtë, pyetjet nëse kjo duhet të merret parasysh dhe si, do të jenë në kuadër të gjykatave ose autoriteteve nacionale kompetente, të cilët shqyrtojnë rrethanat specifike të çdo rasti.

[1 Duke qenë se funksionet kuazi-gjyqësore të Komitetit të Ministrave, sipas nenit 32 të mëparshëm të Konventës, do të pushojnë në një të ardhme të afërt, vendimet e Komitetit të Ministrave nuk përmenden. Megjithatë, nënkuptohet se nëse raste të caktuara akoma shqyrtohen në momentin e miratimit të rekomandimit, parimet e këtij rekomandimi do të zbatohen edhe në ato raste.

